


85H-32

C 35



HYJNI CEKA

Horizonte të elektrifikuara

TREGIME

891.983-32

C 35

HYJNI CEKA

S

HORIZONTE TE ELEKTRIFIKUARA

(Tregime)

492 ~~50972~~

LIBRARIJA E SHTETIT
GJYKONIA

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Piktor: ÇLIRIM CEKA.

Tirazhi 8000 kopje Format 70 x 100/32 Stash: 2204-65

Shtyp NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NENTORI» — Tiranë, 1969

HORIZONTE TË ELEKTRIFIKUARA

Sa kënaqem kur udhëtoj natën nëpër Fushë të Elbasanit! Autobuzi merr të përpjetën e Shirgjanit e del në Qafë të Gjonmes. Luginën e kam në pëllëmbë të dorës. Mbështes fytyrën në xham dhe sytë zënë e më çelen. Një det gjithë drita, det i gjerë, që hapet në të katër anët. Vështroj tej horizonteve të elektrifikuara e s'ngopem. Bota lahet në dritë!

Më shkrep të emëroj kostelacionet. Ai prush llambash, që nis nga Elbasani e merr nëpër Bal-tëz e buzës së Shkumbinit, është Kashta e Kum-trit. Harusha e Madhe ka dalë në Gur të Vashës, e Vogla mbi Godolesh, aty ka zënë vend edhe Ylli Polar. Fushës janë shpërndarë Kocka, Perustia...

Vështroj dhe kujtimet më çojnë në fëmijërinë time. Gërmoj në mendje dhe kërktoj mbrëmjen, kur e mora për herë të parë atë rrugë, shumë e shumë vite më parë... Ishte kohë fiqsh, gusht në të dalë.

E kisha plasur nënën ato vite:

— Po si s'më dërgove një herë në katund, moj momë?! Si s'më dërgove?

Në lagje vetëm unë kisha mbetur pa shkuar në katund. Parë e kisha, se Godoleshi ja, përballë ishte me ato ahure, që dukeshin si kuti shkrepseje nga larg; për të dëgjuar prapë kisha dëgjuar. Po ndryshe të parët së largu, ndryshe edhe të dëgjuarit, ke të shkosh vetë e të rrosh atje një ditë! Shumë a pak kështu i qahesha vetes në moshën tetëvjeçare...

Dëshirën për të parë fshatin ma pat shtuar atëhere një këngë e bukur, që, si duket, qe ndrequr nga mësuesit tanë. S'e mbaj mend se ç'thoshte e gjitha po në kokë më janë ngulitur disa vargje:

Hej, se sa bukur, moj, rrojmë në katund-e

.
E kur bagëtia dalin-e tuf'-tuf' me kullot-e,
bariu prapa vjen-e, fyellit po ja thot-e.

Dhe ty - ry - ty e shoqëronim ne këngën duke imituar fyellin. S'kishte melodi më të bukur se ajo! Rrugë më rrugë e dëgjoje, me orë të tëra e këndoje e prapë doja t'ja merrja, ashtu si barinjtë me ty - ry - ty. Në imagjinatën time qe krijuar një fshat i bukur me shtëpi të bardha, ku gjithë ditën dëgjo-heshin vetëm fyejt e tringëllimat e zileve. Pa le tufat e bagëtive! Kodrat veshur me gjelbërim, fushat gjithë lule. Sa herë që i përfytyroja gjithë këto, plasja me vete, plasja dhe të tjerët:

— Po si s'më dërgon një herë në katund, moj momë, si s'më dërgon?

Për në fshat u nisa një mbrëmje gushti. Ja, si tani, kohë fiqsh. Hipa në gomar, në gomar hipi edhe Xhipi, ai druvari, në shtëpinë e të cilit po

veja. Kam qenë i pashetitur dhe nuk e di se si ta rrëfej lumturinë time: gjithë gaz e shend kur dolën kafshët nga shtëpia! Majë samarit mora rru-gën e fshatit e më bëhej sikur nuk do të arrija atje. S'do të kisha atë fat të dëgjoja fyej e zile, të shihja çoban e bagëti, blerim e lulëzim! E sa e kam ngarë atë gomar të ngratë! Si e si të largo-hesha se, kushedi, ndonjërit mund t'i mbushej men-dja e më kthente. Ç'isha unë? Tetë vjeç! Kush nuk e urdhëron një tetëvjeçar!

Mbaj mend se ura e Shkumbinit më pat mah-nitur. E para herë që e shihja. Sa e gjatë! Dhjetë-këmbëshe. Dhe atje, në urë, rreshtohej një varg i pambaruar gomarësh. Vetëm gomarë me nënbishtje druri!

Me të dalë në fushë, zura të çapëlej sytë. Kër-koja fshatin e këngëve. Xhipi heshte e gomarët ecnin anë xhadesë, në pluhur të rrahur. Nisa të këndojo:

«Hej, se sa bukur, moj, rrojmë në katund-e!»

Mbi xhade kasolle, ku trumbë, ku varg. Kaso-lle me shufra e baltë, mbuluar me kashtë elbi. Preva këngën dhe vështroja. Veshët i mbaja të ngre-hur, i dëshëruar për të dëgjuar jehonën e atij fye-lli, që imitoja në shkollë e rrugëve.

«Po ç'janë gjithë këto kasolle?!»

Ajo zemër kalamani, ajo mendje e njomë fëmi-je nuk donte të besonte se në baltë e në kashtë rrojnë njerëz.

Gomarët sikur i vyshkën lllapat e veshëve, kok-ulur rrihnin thundrat nëpër pluhur. Ecnin e s'ndi-heshin, po me një hap. Kashta, që kish çarë lë-kurën, u dilte mbi samar. Ç'të bënte i shkreti Xhip?! Me ata gomarë nxirrte bukën fëmijëve! Ve-

rës dy herë në ditë vinte, dhe një lagje mbushte me dru.

Druvari fishkëlleu një kaba me të qarë. Unë kërkoja fshatin e këngës.

Rruga kalonte nëpër Mjekës. Në fushë e mbi fushë prapë kasolle, korronecë e mullarë. Përçark gjerdhe. Sa shumë gjerdhe! Mbi togje plehrash zhgërrytnin pulat. Për herë të parë pashë bashkëmoshatarë të mi të veshur me një tek linjë që nga koka gjer te këmbët. Qenë të verdhë e barkfryrë. Të vegjlit qëndronin buzë xhadesë dhe vërenin udhëtarët që ktheheshin varg nga pazari... Unë i rashë mes për mes fshatit dhe as që desha të besoja se rreth meje ishte fshati. Zemra s'më bënte; kënga më turbullonte.

Pastaj rruga mori drejt. Sa drejt! Kafshët gjetën rast e u vunë në rresht. Varg i pambaruar. Gomarë me nënbishtje druri, ngarkuar me thasë specash. Parakalim i çuditshëm. Këngën e pata lënë. Hapa sytë të gjej fshatin e s'po më dilte në asnjë anë. Tej, rrugës, vetëm kasolle. Vrisja mendjen.

«E ç'duhen gjithë këto?»

Dielli zuri të futej thellë grykës së Shkumbinit. Xhipi, që gjithë rrugës nuk hapi gojë, gjeti rast të pëshpërisë:

— Rroi dielli (kështu e tregonin fshatarët përrëndimin).

Tani zemra nisi të më cëmbojë më tepër. Buzët m'u varën e më vinte keq që nuk do ta shihja me ditë fshatin që përmendja nëpër këngë.

Xhipi ishte një fshatar i qetë. I gjatë e i thatë si gjithë shpatarakët. Udhëtonte e tundej mbi gomar. Ai nuk mërzitej si unë. Kafshës i kish hipur

anash dhe, sa herë që vritej në të djathtë, kthehej majtas. Kur i çanin hundët për duhan, nxirrte trastën, aty kish edhe uror edhe gur stralli. Kur zinte eshka, mua, më kënaqte era e saj. Sa i mirë ish druvari! Në të rrallë më thosh ndonjë fjalë. Më kish lënë në hallin tim: të shihja fushën e tharë e të merresha me përfytyrimet e mija. S'e dinte ai se ç'doja unë atë mbrëmje. E si mund të kërkojë një fëmijë të gjitha ato që thuhën nëpër këngë?

Përpara se të zbriste nata, gomarët kthyen te vidhet, buzë kodrës. Aty pinin ujë kafshët, aty pinin ujë dhe njerëzit. Bashkë, në një burim si hurdhë. Zuri të më kapë trishtimi. Këtë s'ma kishin thënë mësuesit e gjëkundi s'e pata dëgjuar nëpër këngë. Po shpejt do të mësoja atje tek po veja, se, në jetë, njerëzit dhe kafshët shpesh ishin ortakë.

Muarëm të përpjetën në Shirgjan e nata pat rënë. Po s'ishte natë si kjo e sotmja. Kur hodha sytë në Qafë të Gjonmës, fushën e pashë të nxirë e të heshtur. Një det i mugët shtrihej në të katër anët, një botë e ndrydhur dhe e tulatur. Fusha qante e tharë dhe e rreshkur. Dhe mua trishtimi më hapi një si gropë këtu, në lukth.

«Nga po na shpinin këto kafshë?»

Në të përpjetat, herë xixëllinte, herë shuhej. Qentë lehnin me të madhe. Si lamë xhadenë, u ngjitëm rrugëve të ngushta e ferrave. Poshtë s'doja të shihja më. Më trembte zbratësia dhe errësira e hohneve. Shikoja përpara e zgjyra më vriste sytë. Vetëm në qiell ndritnin yje. Ç'yje! Unë atëhere u besoja vetëm këngëve.

Udhëtonim e udhëtonim... Mendja s'më vinte më te kënga. Prisja ç'do të më dilte përpara mbas

asaj rruge të gjatë. Nga ana e anës vinin vetëm lehjet e qenve dhe herë herë sokëllima të largëta.

Në majë të kodrës lamë në të djathtë prapë hije kasollesh dhe xixa kandili. Qentë na shoqëronin deri poshtë. Në gropë, mbas mullarëve e korrorecëve, na dolën, si zakonisht, kasolle rrethuar me gjerdhe, zhytur në errësirë. Xhipi më lajmëroi se po afroheshim në shtëpinë e tij. Doja të kishte dritë. Më mbante një farë shprese se do ta shihja fshatin tim të këngëve.

U ngjitëm në të përpjetë e dolëm në një qafë, shulorja tjetër vinte e shkurtër, rruga kalonte nëpër shesh. Po arrinim në Shegas, nata që mbushur me zhurmë e me xixa. Nga larg, herë afroheshin, herë shuheshin ca biseda të mbytura e blegërima. Era sillte vlagë plehu e lehje qensh.

Gomarët ecën sa ecën, pastaj ndaluan ballë një trine. Mbas pahisë e mbas gardhit ndodhej një shesh e një kasolle e një man në mes të sheshit. Druvari thirri me zë të vrazhdë:

— Oj Xhipore!

— Lepe! — u dëgjua përgjegja nën pullazin me kashtë.

Zagarët sa nuk u tërbuan dhe unë s'merrja vesh fare ç'kishte ndodhur.

Druvari çeli pahinë dhe futi kafshët në oborr, unë majë gomarit pyesja i mërzitur:

— Ku ndaluan kështu, o daj Xhipi?

— Në shtëpi, or Cen!

— Shkojmë në katund, o daj Xhipi. Pse ndaluan këtu te kasollet?

— Po ky është katundi, zbrit se erdhëm!

Unë u shastisa.

«Çfarë katundi është ky? Katund me kasolle!

Ku është parë kjo punë!..» Më vinte ta zija Xhipin prej setre e ta bindja: «E ke dëgjuar, apo s'e ke dëgjuar atë këngën e shkollës sonë? Ku më solle kështu, apo lajthite rrugën?»

Druvari shkarkonte hejbet me specë.

Zbrita i vrarë. Xhiporja doli me bishtuk, erdhën edhe carrojtë me lija të gjata. Të gjithë m'u mblodhëm përçark, kush të më përçafonte, kush të më përkëdhelte, po unë qesh aq i pezmatuar, sa nuk e çela gojën fare. Sa e mirë që ishte ajo Xhipore! Shpirt njeriu! Se ku i gjente ato fjalë të ëmbla:

— Oj fale, oj zemër!

Po mendja ime bridhte gjetkë.

«Këtu është shtëpia e Nexhipit, po s'është katundi. S'ka si të jetë ndryshe! Nuk do të gënjente kënga, kur thoshte «Hej se sa bukur rrojmë në katund!»

Çfarë nuk mendoja në ato çaste, prandaj, kur u futëm brenda i thashë menjëherë Xhipit:

— Po mirë, ky është katundi, o daj Xhipi?

— Ky është! — u përgjegj druvari dhe hetonte në fytyrën time.

— Nu ka më katund në tjetër vend?

— Ka sa të duash, si s'ka?

— Po qysh janë ata të tjerët?

— Po ja, si ky yni.

— Të gjithë?

— Të gjithë.

— Ou, pse me kasolle qenkan?!

— Në kasolle rrojmë ne, or Cen! S'bëjmë dot shtëpi, se jemi në tokë të beut.

Këtë bisedë të Xhipit s'e kapja dot atëhere dhe as që e kuptova se ç'mbanin ato fjalë «Jemi në tokë të beut!» Ndaj dhe s'u ngushullova e fyti m'u

ngjir e goja m'u tha. Buzët dalëngadalë po më shtrembëroheshin e po më dridheshin. Me zor shtrëngohesha ta mbaja veten. Xhiporja e ëmbël më mori pranë e më përkëdhelte:

— Oj, m'u rritsh!

Unë nxirrja fytyrën nga krahët e saj dhe vështroja kasollen skutë më skutë. Çuditesha me fijet e kashtës që vareshin nga lart gjithë blozë e gjithë pluhur. Gjer atëhere nuk kisha parë një kthinë aq të zezë. Nxinte në të katër anët. Unë habitesha me çdo gjë që shihja: me tymin, me saçin mbi flakë, me njerëzit që kullonin djersë. Po sa të vogla ato dritare, si dritare kafazi!


«Të ishin kështu të gjitha shtëpitë e katundit? Po pse ma patën mësuar atë këngë?»

Siç e shihni, kam qënë i pamësuar. Kjo vinte edhe ngaqë s'kisha shetitur e s'kisha parë botë me sy. Nuk duhet ta mendoja këtë? I varfëri Xhip, mirë që gjente vajguri për bishtukun!

...Sa fjeti lumi, aq mbylla sy edhe unë atë natë. Aty, mbi rrogos e mbi thekje, jepja e merrja me vete. Sa kasolle kishte nëpër fushë e kodër! Vetëm kasolle paska fshati! Rrotullohesha nëpër shtresa dhe hahesha me këngën. «Hej, se sa bukur, moj, rrojmë në katund» — Si mund të gënjente kënga?!

Kapakët s'më mbylleshin, ndjehesha i poshtëruar.

Mbas trine dhe bagëtia nuk flinte. Më bënte shoqëri atë natë. Me të rënë, dëgjova kaun që për-typte; i kërcisnin dhëmbët dhe si mokër dhe si gërshërë. Herëpashere kruheshin delet dhe unë numëroja trokëllimën e një trakeje të ndryshkur që lëvizte ritmikiisht. Gomarët pallën në mesnatë, po fort, pastaj u dëgjuan vetëm gjelat. Me gjelat u mësova, se kishin zë të hollë e të bukur.



Po ndaj të gdhirë u bë një pushim i gjatë. Pra-
pë u zura me këngën dhe s'u përmbajta më. Qava
e qava heshtas, po me dënesë.

I pari më ndjeu Xhipi e foli:

— Oj Xhipore, shiko atë çun, moj, se po qan!

Gruaja e ëmbël u ngrit e mori atë kandil bisht-
gjatë. Sytë i shtrëngova fort, po duket se lotët më
patën mbetur. Atëhere Xhiporja më mbuloi:

— Ka parë ëndërr... Oj m'u rritsh!

* * *

... Ndaj e dua udhëtimin e natës nëpër Fushën
e Elbasanit. Të bredh në qiell pa yje e pa hënë e të
kënaqem me bukuritë e dritës sonë. Shoferit i lu-
tem ta ngasë maqinën sa më në anë të xhadesë. S'më
mban vendi kur shikoj dhomat që ndrijnë mbas per-
deve, kur llambat feksin nëpër sallone e radiot
mbushin shtëpitë me këngë. Vetëm atëhere dua të
këndoju:

«Hej, se sa bukur, moj, rrojmë në katund-e!»
Bregën e fëminisë e harroj fare dhe shikoj
përpara, drejt horizonteve të elektrifikuara!

PËR NJË BALLË FISHEKE

Ne banonim asikohe në lagjen e krishterë të qytetit. Shtëpinë e kishim pranë kishës. Ky pozicion më pat nxjerrë ngatërresa në fëmijëri. Kur më duhej të shkoja në shtëpinë e gjyshes, hiqja pikën e zezë nga të vegjlit e lagjes tjetër. Të gjithë më prisnin me romuze, më sillnin me gurë dhe rruga gjëmonte: «Erdhi kauri!»

Një ditë, dera u ndodh mbyllur. Gjyshja nuk gjendej aty. Ç'të dëgjoje! Nuk vonoi dhe nga shtëpia ngjitur doli çuni i nënë Zajes. Ai e mori përpara atë turmë fëmijësh. Kështu ndodhi që unë njoha Nazmiun, djalin e madh të fqinjës së gjyshes.

Miq u bëmë vonë. Kjo ngjau pas nja dy vjetësh, kur unë vazhdoja klasën e katërt të fillores dhe ai sa kishte hyrë në Qytetse.* Atëhere pata nisur të shkruaja. Vjershat e mia ndoshta s'e kishin bukurinë e poezive të vjershëtorëve, po shokëve të mi u pëlqenin. Nganjëherë më ndalnin në mes të rrugës, kërkonin që t'u recitoja. Më pas këto i pata mbledhur në një fletore me kapakë të trashë, që shetiste dorë më dorë.

* Shkollë e mesme.

...Në qytetin tonë patën filluar demonstratat e para. Qenë vrarë disa spiunë. Çdo ditë qëllonte që digjeshin kamionë të ngarkuar me bar. Ndërsa nëtët s'ishin aspak të qeta: o do të kishte përpjekje me armë, o do të ndriçohej i gjithë qyteti nga zjarri i rdonjë depoje në flakë. Kudo vepronin njësitet guerile

Atëhere ne flisnim hapur kundër fashizmit. Në klasë, mësuesit tanë bisedën e sillnin gjithnjë kundër pushtuesit. Edhe unë vjershat e mia i har-toja për luftën e popullit tonë. Këto vjersha i recitoja hapur. Nuk kisha frikë se më kallëzonin, sepse fashizmin e urrenin të gjithë.

Tamam në këtë kohë ne u bëmë miq me Nazmiun. Ai kërkonte t'i recitoja ndonjë vjershë dhe unë s'përtoja. Këto poezi shpesh ishin thirrje të zjarrita, si ato të komunikatave. Njërën prej tyre e kujtoj edhe sot. Ajo niste kështu:

*Zëri i Shqipërisë,
shokë, na thërret,
të rrokim armt e trimërisë,
se mali po na pret!*

Nazmiu dëgjonte vjershën dhe pyeste:

- Vetë e ke bërë?
- Vetë.
- S'ke parë nëpër libra?
- Hiç fare!
- Je i vetmi!

...Lufta pat marrë hov. Njerëzit i pat zënë halli i atdheut të robëruar, qenë bërë të dashur e të

afërt me njëri-tjetrin. Fëmijët e lagjes së gjyshes qenë miqësuar me mua. Atëhere ne mblidheshim në rrugën e Kullollit. Lexonim trakte e vjersha dhe shpesh këndonim këngë partizane.

Më 7 nëndor 1942 u formua grupi i parë i pionierëve elbasanas. Bashkë me Nazmiun, në këtë grup merrja pjesë edhe unë. Organizata na lidhi më tepër. Shkonim gjithnjë bashkë, tok rrinim përherë. Të dielave mbasdreke ai do të më priste te bashkia. Merrnim rrugën nga «Gjurma e mushkës», kthenim e dilnim tek ngrihej traseja e lënë e hekurudhës, pastaj ecnim në të djathtë deri te livadhet në «Narazane». Atje na prisnin shokët tanë, fëmijë të gjallë e të zjarrtë, midis të cilëve dalloheshin ata të lagjes së Xhaxhit, «Xhaxhurët», që i drejtonte Lami. Qenë shpuzë. Shtëpitë i kishin pranë kazermave dhe në mbledhje s'vinin kurrë duarbosh. Herë sillnin bomba dore, herë fishekë; edhe predha mortajash patën sjellë, nga ato të kuqet me fletë ngjyrë qielli.

Udhëheqësi ynë, shoku Dyl, i lëvdonte shpesh xhaxhurët për guximin e tyre; edhe unë i admiroja për trimërinë e gjallërinë. Fundja ata ishin pionierë luftëtarë. Ç'ishin vjershat e mia? Fishekë, ore, fishekë, këto na duheshin për të vrarë armiqtë. Gjumi i natës nuk më zinte sa të shtija në dorë ndonjë armë, të paktën një ballë fishekë. Këtë ja tregoja dhe Nazmiut, mikut tim, po ai, në vend që të më nxiste, më lëndonte edhe më shumë:

— Je i vogël, prit sa të rritesh!

Fjalë ishin këto?! Isha i vogël unë që kisha mbushur një fletore me vjersha! Pastaj të prisja sa të rritesha! Shoipëria do të clirohei gjer atëhere. E ç'bëra unë?! Kështu arësyevoja me Nazmiun. Kësh-

tu flisja edhe me veten time... dhe ja ç'na solli rasti.

Kodrave kisha dalë me shokët për mëllenja. Ne vraponim nëpër gëmusha e duke bërë hu - hu - hu, ... hu - hu - hu, hutonim ata zogj me mish të shijshëm, kur pranë fare dëgjuam krismë pushke. U afruam dhe pamë një milic që gjuante edhe ai mëllenja. Sa i urrenim ata milicë me ato rroba gjithë vija të zeza! Si gjithnjë, edhe kësaj here, me që takuam një milic, ne ja muarëm një kënge, që e këndonim në kësi rastesh. Në fillim me zë të ulët, pastaj duke e ngritur, por po atë strofë:

*Milic hor xhubleta,
shif ku t'çon kuleta,
parja huej e shkreta
t'ban me vra villan' tand.*

Erdh një çast e milici, si mbajti vesh mirë, kuptoi se ajo këndohej për të, prandaj m'u drejtua:

— Or voc, ç'asht ajo kangë, bre?!

Sy për sy ja prita atëhere:

— Kjo është kënga e tre heronjve të Shkodrës, që u vranë nga fashistët dhe milicët tradhëtarë.

Vura re se ai shtangu me armë në dorë, u trondit dhe u shushat nga fjalët e mia. Sytë i çapëleu dhe s'po merrja vesh, a donte të qeshte, apo donte të qante.

— As e merr edhe një herë atë kangë trimash, or voc!

Ne ja muarëm edhe një herë nga fillimi deri në fund.

Si mbaruam këngën, e pamë atë burrë gjithë mustaqe t'i mbushen sytë me lot.

— Afrohu, or voc! — më foli.

— Më jep fjalën që s'më nget!

— Fjalë trimash, bre.

Ne ju afruam. E kuptuam që e kishin marrë me zor dhe e kishin mashtruar. Ai më shtrëngoi dorën. Pastaj nxori një kuti të madhe duhani dhe ma drejtoi mua. Ne s'ja pranuam.

— Ti je burrë, bre! Ani se je i vogël me shtat.

— Jo, jo, duhanin s'e pimë! — ju përgjegja unë së dyti.

— E çfarë do prej meje, or çun?

— Ti heqësh ato rroba të ndyta, ja këtë duam prej teje.

— E çuna, çuna, këtë punë mixha ka ditë që e peshon. Më pastë më qafë kapidani, që më hangri në besë, po mixha s'asht ka e bajt ma këtë robe.

Kështu foli ai malësor i gënjyer atë ditë në ullishte. Ne i kërkuam bombë dore, po s'na dha. Druhej se vriteshim, na fali një ballë fishekë dhe na premtoi si burrat se do të zvishej prej asaj robe të ndyrë.

...Ishte e para herë që mbaja në dorë material luftarak. Një ballë... gjashtë fishekë dhe rrija e mendoja atë partizan që do t'i përdorte. Me gjashtë fishekë mund të vriteshin gjashtë fashistë. Pa le sikur fashistët të ndodheshin në rresht: njëri pas tjetrit. Plumbi depërton tejprtej nëpër gjashtë vetë. Sa do të gëzohej shoku Dyl! Kjo ishte ndihmë për luftën!

Atë ditë qëlloi e djelë. Në pasdreke kishim mbledhje në «Narazane». Mua s'më mbante vendi.

Në shtëpi ndenja sa hëngra drekë, ashtu më këmbë shpejt e shpejt. Ku e kisha mendjen te buka! Fluturova te shtëpia e Nazmiut. Po ç'e do, s'e gjeta aty.

Mora vrap në «Narazanë». Te çairi ynë gjeta Nazmiun, Lamin dhe xhaxhurët. Kishin ardhur me kohë. Bukën e kishin marrë me vehte dhe hanin atje.

Në grupin tonë, ai Lami ka qenë i shkathët fort e hokatar që s'e kishte shokun, po dhe ngacmonte tepër, prandaj, me ta parë, një herë u stepa e s'po tregoja gjë. Erdha e erdha rrotull, pastaj ballën e fishekëve ja tregova veças Nazmiut. Më pyeti si e qysh e pata shtënë në dorë, pastaj më përgëzoi.

Po kishte gjë në grup që të mos shkonte në vesh të Lamit! Atë e mbanim të ditur për çdo gjë. Andaj edhe Nazmiu atë ballë fishekësh ja dha atij. Si të ishte ushtar i sprovuar, Lami përcaktoi kalibrin e fishekëve dhe modelin e pushkës. Pastaj se ç'i shkrepri:

— Do të shtiem me këta fishekë?

— S'kemi pushkë.

— Me zjarr!

— Mos, shoku Lam, mos i humb kot ata fishekë! — ja prita unë.

— He, more, ti ke frikë nga krisma e fishekëve! S'desha të jepem. Të gjithë u shpërndamë për shkarpa. Shpejt e shpejt u ndez zjari e, si u ngri-tën gjuhët e flakëve, Lami thirri:

— Shpërndahuni! Barkas!

Ne u shpërndamë të gjithë. Lami hodhi fishekët në zjarr. Mbas pak u dëgjuan gjashtë krisma të mbytura.

Mua më dogjën ata gjashtë fishekë.

Shoku Dyl erdhi shpejt. Pionierët u mblodhën rreth tij. Vajta dhe unë helm e pikë. Ç'pata ëndërruar e si më doli.

Bisedën për fishekët e hapi vetë shoku Dyl. Ai kishte dëgjuar krismat tek vinte. E, meqë atij ne s'i fshihnim gjë, ja treguam të gjitha për pe, me shaka e duke qeshur. Ai u ngrys e u grys dhe na qortoi rëndë të gjithëve. Foli ashtu si pata menduar unë:

— Fishekët duhet t'i zbrazim në kokë të armikut. Me atë ballë, gjashtë fashistë vritnin partizanët tanë.

Ne, të zënë në faj, dëgjonim kokulur. Fjalët e tij na prekën mjaft. Ai foli pastaj edhe për shumë gjëra të tjera: për gjendjen e brendshme, për gjendjen e jashtme, por mendja jonë nuk shqitej nga fishekët e plasur kot. Qortimi i shokut Dyl i theri në zemër të gjithë dhe... më shumë Nazmiun, Lamin dhe mua. U ndamë si të rrahur atë ditë.

...Kaloi një javë, erdhi përsëri e diela, që gëzonte e bashkonte pesëdhjetë pionierë nga të katër anët e qytetit tonë, e diela që na flakëronte zemrat. Qysh në pasdreke herë ne qemë mbledhur në çairin tonë. Atë ditë na bënë merak ca pushkë e një breshëri mitralozi që u dëgjua nga kazermat. Të shtënat vazhduan të rralla edhe për ca kohë e pushuan atë nga ora tre. Atëhere ne filluam mbledhjen. Ishim që të gjithë, veç Nazmiut e Lamit. Shoku Dyl, i shqetësuar, vazhdoi të na flasë. Dëgjonim dhe mendja shkëputej herë-herë fluturonte te Nazmiu dhe Lami. Ata s'kishin munguar asnjë të dielë.

... Si mbaroi mbledhja, shoku Dyl, që e shih-

te në sytë e të vegjëlve shqetësimin, për të hequr merakun, m'u drejtua mua:

— Pa na lexo, o Cen, atë vjershën e fundit.

Atë kohë që ndërruar përsëri qeveria fashiste. Kryeministër që bërë tradhëtari Eqrem Libohova. Me këtë rast i pata qëndisur atij një të hollë, të cilën e kishte pëlqyer edhe shoku Dyl. Pa u druajtur, dola përpara shokëve dhe e recitova atë vjershë, që e pëlqej edhe sot:

*Eqrem beu na ishte ndrrue
ke Pariani don me shkue,
ke Pariani gjysëm mbret,
që ka ramun në siklet.
Ke ai kur paska shkue,
kryeministër asht emnue.
Ky nishani ç'e gëzoi,
dorën nalt se ç'na e çoi,
romanjölçe na nderoi
e thërriti: «Re a noi!» *)*


Shokët të gjithë qeshën. Vjershën e pëlqyen mjaft. E, kur u pëlqente atyre, mua zemra më bëhej mal. Gajasëm sa gajasëm e, kur po bëheshim gati të largoheshim, dëgjuam çape matanë gardhit. Luajti një degë; u tund një gëmushë dhe bëri ballë Nazmiu e pas tij Lami me thes krahëve, gjithë hoka e rromuze. Ne u hapëm vend. Lami vendosi thesin mes nesh.

— Kush e gjen ç'ka thesi? — thirri Lami.

— Duhan! — ja pritëm ne, se duhan shishte Lami.

— Cigare, thoni më mirë! — foli Nazmiu.

*) Thirrje fashistësh: «Mbreti me ne».



— Cigare që tingëllojnë! — bëri shaka një tjetër.

— Cigare për partizanët! — tha Lami duke ju drejtuar shokut Dyl. Pastaj hapi grykën e thesit dhe nisi të nxjerrë prej andej një shirit mitralozi. Tërhiq e tërhiq e për çudinë tonë, ai s'kish të sosur.

— Për një ballë, një shirit mitralozi sollëm, shoku Dyl. Sa fashistë qëron ky, — dhe e ngriti lart vargun e fishekëve.

Ne qeshëm, po s'qeshi shoku Dyl.

— Ajo varet si t'i shprazim, o Lam!

— Në kokat e armiqve, shoku Dyl!

— Ashtu po, do t'i qërojmë të gjithë fashistët e do ta çlirojmë Shqipërinë.

Kësaj radhe qeshëm me gjithë zemër.

— Si ju ra në dorë ky varg fishekësh, o çuna? — pyeti përgjegjësi ynë.

— A i dëgjuat ato pushkë në drekë?

— I dëgjuam, — u përgjegjëm ne.

— Këta farë burrash i bënë ato dy orë luftë, — u mburr Lami, e tregoi veten e Nazmiun. — Shiritin ja muarrëm «Breshkës».

«Breshka» ishte një tank i lehtë që fashistët e shëtitnin qytetit, sa herë që kryenin ndonjë aksion partizanët rreth Elbasanit. Njerëzia, në vend që të trembej, i pat vënë këtë emër të shëmtuar tankut.

Lami shiste duhan të grirë në kazermë dhe prej kohe ja kishte qepur sytë shiritit të «Breshkës». Atë të dielë i qe mbushur mendja për aksion dhe qe nisur së bashku me Nazmiun. Kësi punësh ata gjithnjë i bënë tok.

— Po si shpëtuat, o çuna?

— Ohu, kur filluan të qëllojnë fashistët, ne kishim kohë që patëm mbaruar punë. Po na lodhi. «Breshka e dreqit. Me dhëmbë e kemi shqitur shiritin nga mitralozi.

Ne të gjithë e admironim atë varg të pambarruar fishekësh. Ishte dhurata më e çmuar që bënim për çetat. Vendosëm aty për aty që dhuratën t'ua nisnim vetë partizanëve, dhe kështu bëmë.

Shiritin, brenda në thes, e dërgoi në Shalëz Nazmiu e s'u kthye më. Mbeti atje në çetën e Dumresë.

... Kaloi kohë qysh nga ajo ditë. Më 11 nëndor 1944, Elbasani u çlirua. Të nesërmen e çlirimtarit, te bashkia u vendos Këshilli nacional-çlirimtar i qytetit. Bëheshin përgatitje për të pritur shtabin e qarkut. Një tog pionierësh të grupit tonë, me Lamin në krye, u thirrën korierë në Këshill e bashkë me ta edhe unë.

Atë mbrëmje ja behu në bashki shoku ynë i vjetër, Dyli. S'njihej më. Pallton prej lëkure, kapën partizane me yll, mustaqet e kishin ndryshuar fare. Qe më i regjur e më i fortë. Ishte anëtar i shtabit të qarkut.

Duke kaluar koridoreve, s'na vuri re. Në këshill i thanë për ne, doli në frymët e na përqafoi si vëllezër. Në krenoheshim për udhëheqësin tonë.

Gjithë atë ditë qyteti ziente. Këngë e valle shesheve e tek-tuk, nga gazi, ndokush qëllonte me pushkë. Krisma u dëgjuan edhe aty pranë. Në një shtëpi ngjitur me bashkinë dikush harxhoi një ballë fishekë, gjashtë të shtëna pushke.

Shoku Dyl urdhëroi ta thërrisnin partizanin që qëllonte me pushkë.

Përpara tij u paraqit partizan Nazmiu. Shoku

Dyl s'u përmbajt, u ngrit dhe e përqafoi luftëtarin pionier.

— Na i shkove kot fishekët, o Nazmi, s'ka mbaruar lufta ende.

— Të drejtë ke, o shoku Dyl, po kësaj here e bëra vetëm për hatrin e nënës. Kishte dy vjet pa më parë, m'u lut të shtija një herë. S'i besohej që di të qëlloj.

— Po qe kështu, ke të drejtë. Megjithatë të kujtohet ç'patëm thënë në grup?

— Si ta kem harruar, shoku Dyl?! — dhe ushtarakisht, me zë të lartë, Nazmiu përsëriti atë fjalë që dy vjet më parë e pat thënë Dyli: «Fishekun ta zbrazim në kokë të armikut».

MBAS DEMOSTRATES...

Vapë e ufëm pati ajo verë.

Këmbët të përcëlloheshin në tokën shkru mb,
e sytë qanin për një bulë shi.

Nuk shihje gjë tjetër asikohe, veç njerëz të mbledhur mizë lisi pranë furrave. Atë vit mbahet mend që shkoi çerekja e misrit dhjetë napolona. Njerëzia vuanin për kafshatën e bukës, po tregëtarët dhe agallarët sikur nuk u ngopën me kaq dhe filluan ta fshehin drithin për ta shitur dimrit shtrenjtë e më shtrenjtë.

Plasi atëhere demonstrata e bukës në Elbasan... Demonstratë ajo pati emrin, po qe luftë e shkuar luftës. Betejë në mes të qytetit. Populli me grushta e me popla, fashistët me dyfekë e bajoneta. Atë ditë fukaraja u ngrit për bukën e jetës e t'i shikoje milicët si u derdhën nëpër qytet! Djem e vajza u kacafytën me armiqtë, komunistët në ballë e vetë shoku Topi në krye. Tregëtarët, për t'i shpëtuar sherrit, mbyllnin dyqanet gjithë zhurmë, fshiheshin prapa qepenave dhe ruanin nga brimat e çelsave, kur gjakosej rinia... Ja, ç'kanë qenë tregëtarët!

Mbas demonstratës burgu i madh në mes të la-

gjes sonë u mbush plot e përplot. Të burgosur nëpër qeli, të burgosur edhe në pajdos (shesh burgu), në pikë të diellit e në mes të zhegut. Ku qe lulja e Elbanit, u mbyll prapa hekurave. Po ku donte t'ja dinte ajo rini! Qyteti s'pat gjëmuar ndonjëherë si atë verë. Kënga vlonte në burg, e ç'këngë! Ajo çante muret e trasha e fluturonte mbi telat plot gjëmba.

Ato ditë ndodhën këto ngjarje që desha t'ju kujtoj.

Lami është ai djali kokërrumbullakët për të cilin ju kam folur. Përherë toç, ndaj dukej edhe më i vogël. Të shtunave shiste thasë, se mbante shtëpinë me bukë, që kur i vëllai kishte marrë malin e pat mbetur ai i parë shtëpie. Për zgjuarsi e shkathësi s'kishte shok, po ka qenë edhe trim. Kjo bëri që atëhere emri t'i dëgjohej në gjithë qytetin.

Ai e pat mbledhur mendjen top. Fashistëve u duhej punuar ndonjë rreng. Ata katilë na patën mjeruar dhe vëllezërit e motrat na i patën mbyllur nëpër burgje... dhe Lami e nisi punën më herët se çdo ditë. Mblodhi xhaxhurët e tij, *) ata xhaxhurët e besës, që bënë aksione në mes të kazermave e s'donin t'ja dinin as për milicë, as për karabinierë. U thirri të gjithëve shtëpi më shtëpi, i grumbulloi në mes të lagjes, te varrezat e Xhaxhit dhe u çfaqti ato mendime që bluante prej kohësh:

— Punë është kjo që bëjmë ne, po a rrihet duarkryq kur shokët na i burgos fashizmi?

*) Fëmijë të lagjes së Xhaxhit në Elbasan, që u aktivizuan shumë gjatë L.N.Çl.

— Jo, kjo s'është mirë, — u përgjigjën xhahurët me një gojë.

— Po mirë, — pyeti prapë Lami, — po a durohen këta kriminelë, që bëjnë si u do qejfi?

Fëmijët heshtën dhe e shikonin Lamin sikur donin t'i thoshin: «Mos i bjerë përqark, o shok, po preje shkurt!»

— Ç'duhet të bëjmë, thoni ju. Atë që na takon. I keni parë kamionët me barë, që digjen në mes të Tabakëve? Shokët e guerileve e bëjnë të vetën. Po shokët s'i bëjnë dot të gjitha.

— Or, po dil, ku do të dalësh, — thirrën ata.

— Kamionët që hyjnë në Elbasan, të mos i lëmë të kaptojnë përtej. T'u shpojme gomat. Ja, këto kisha unë!

Fëmijët u shikuan sy më sy. Ai Lami fliste si burrë e mendja i priste hollë.

Kështu filloi në qytetin tonë një aksion i madh, që çrregulloi për një kohë të gjatë komunikacionin e armikut. Duhet të ketë qenë fund gushti e fillim shtatori, se zhegu përvëlonte. Njerëzia, kur dëgjonin ato pëllcitje si të bombave, kujtonin se vapa po bënte kërdi mbi gomat e kamionëve. Niste atëhere zbërthimi i gomave, ndahe-shin rradhët e disqet, veçohej kamerdarja nga kopertoni, veç kur dilte një alamet gozhdë, që kishte hyrë tej e tej nëpër llastik, si turjelë. Eja t'i mbaje fashistët pastaj. Shoferët zinin e truanin, ndërsa oficerët tërboheshin.

Po se mos ishin një e dy këto raste? S'kalonte ditë pa dëgjuar plasje.

— E pat, — thërrisnin çirakët.

— Me shëndet, — ja pritnin me rromuze çertexhinjtë.

Goma zgërlaqej në mes të rrugës. Italiani zinte e numëronte njëmijë të shara në gjuhën e tij. Njerëzit s'merrnin vesh se ç'thoshte, po i përgjigjeshin nga larg gjithë vrer.

— Gri, or, gri!

— Folë, or, folë!

Fashisti vazhdonte e fukaraja shfrynte marazin që po e mbyste në ato ditë terrori.

Po ku pat fjetur hasmi ndonjëherë, që të flinte fashizmi? Ku qenë sheshe në Elbasan, u mbushën plot xhandarë e milicë. Maqinë e roje. Po, të thuash të drejtën, kuesturës as që i shkante ndër-mend që këto punë i bënin xhaxhurët e vegjël. Fashistët hapnin sytë ndër punëtorë e hamej e s'linin burrë t'u afrohej automjeteve të tyre. Këtë e nuhati ai Lam kokëtoçi dhe nxori ca marifete që të habisnin.

Xhaxhurët zunë të vërtiten nëpër sheshe me topa në duar e gozhda në xhep. Lojën e ngrinin në sy të rojeve dhe luanin a s'luanin. Kur topi ngecte poshtë kamionëve, fëmijët vraponin mbas tij, i mbathnin mirë e mirë gomat me gozhdë e dilnin pastaj pa të keq që andej.

Dhe prit e dëgjo pastaj. Bum këtu, bum matanë. Ndonjëherë dy goma njëherësh: bum, bum!

— Prit, or prit, — thërrisnin çirakët.

Kamioni ushtarak, me gjithë atë municion, mbe-tej në vend.

... Fashistët deri atëhere s'i patën njohur fëmijët shqiptarë. Ata na dinin të varfër, këmbëzbathur e lakuriq. Ne vërtet copë e çikë qemë, po zemrat i kishim barot. Fashistët i kishim halë në sy e, po të mundnim, me dhëmbë i shqyenim. Push-tonjës! Ku do të shkante më tej?!

Qyteti ynë s'kishte bulevardet e lulishte, as she-
she të rregulluara. Te monumenti i Kristoforidhit
binte një kryqëzim rrugësh dhe vendi zgjerohej. Aty
kanë qenë tabakët.* Në kohën e fashizmit aty ndal-
nin me dhjetra kamionë.

E diela e parë e shtatorit të atij viti ka qe-
në një e djelë e qetë dhe e mërzitëshme. Në atë
vapë kishin dalë xhaxhurët në Tabakët me Lamin
mes tyre. Shoferët vinin rreth dyqaneve për të si-
guruar drekën. Nga pijetoret nisi një këngë e
zvarrisur. Ishte kohë për të gjuajtur.

Aksionin e parë e kreu Xheti, maqinën tjetër
e mbërthyen prapë dy xhaxhurë të vegjël. Lamit
s'i erdhi radha, e ai plasi. U nisën dy kamionët e
parë, dy automobilë që tundnin dheun tek shko-
nin. Njëri e dha lajmin nga «Qoshja», i dyti s'priti
të vejë te «Porta e Kalasë»; mbetën të dy në vend.
Aty Lami mori zjarr dhe gjuajti pa marifet nën
rrotat e një maqine. Ai ndoqi këmbadoraz topin.
Në atë kohë, mbrapa një maqine bëri ballë serx-
hent*) Komolioja, një egërsirë, që ngjiste dhe më
ujk dhe më skile. Ecte qetë e qetë dhe kokën herë e
kthente më të majtë, herë më të djathtë; kishte
një fytyrë të shplarë, të bardhë në të verdhë, pa
pikë gjaku.

Xhaxhurët filluan të fishkëllijnë. Lami nën ma-
qinë dëgjoi e zuri të zhdunkte gjurmët. Serxhenti
u drejtua nga kamioni me hap zagari dhe shikoi
ndër rrota. Atëhere vëllai i vogël i Lamit ja dha
britmës:

— O lalë! Ikë, o lalë!

*) Verëde në Eibasan.

* Gradë nënoficeri në policinë fashiste.

Lami rrëshqiti porsi ngjalë nëpër rrota, nëpër duar të Komolios dhe mori vrap nga xhamia. Aty i prenë rrugën dhe e kapën.

E zuri Komolioja dhe sill e bjerë. Nuk ka gjë më të pështirë për një burrë se sa kur qëllon në fëmijë. Po Lami e qepi gojën.

Ai do të gjente një mënyrë për të shpëtuar.

Serxhenti shtrëngonte Lamin për krahu, sikur ç'kishte zënë. Nga gëzimi, s'u drejtua fare në kuesturë. Qe e dielë dhe kuestori gjendej në shtëpi. Atje u drejtua me Lamin.

Kuestori hante drekë e serxhenti s'ja prishi qetësinë. Në atë familje ai ishte si i shtëpisë. Lamin e mbylli në depon e qymyrit, pastaj ngjiti shkallët lehtë e lehtë, me gëzim të papërshkruar për sihariqin që do të jepte. Kuestori e dëgjoi e edhe mirë i vinte, edhe s'i besohej.

Si hangri, kërkoi t'i çonin pionierin. Ai Lam kokëqethuri ju duk pesë para njeri. Kur zunë ta pyesnin, kërkoi ujë. Përpiquej të merrte veten dhe të pregatiste përgjigjen. Ujin ja dhanë; një gotë, dy dhe ai shtirej i etur e i djegur, po mendja i tirrte.

— Ç'deshe nën maqinë? — foli kuestori.

— Mora topin, — ju përgjegj ai prerë.

— Topin, ë ë ë?

Pastaj një shuplakë. Lami kërciti dhëmbët dhe sytë i lëshuan xixa.

— Ti i shpon gomat?

Lami u habit.

— Ti i shpon gomat e maqinave tona, qelbash!

— Me çfarë t'i shpoj? Me top? — dhe Lami nxorri topin.

Ata e qëlluan përsëri e përsëri.

Ja nxorën astarët e xhepave. Filluan ta kontrollonë me imtësi. E çfarë t'i kontrollonin atij fëmije? Tri pëllëmbë njeri ishte dhe dy plaçka robe kishte në shtat. S'i gjetën gjë prej gjëje.

Kuestori mblodhi buzët.

Serxhenti e mori mënjanë majorin dhe seç i pëshpëriti në vesh. Lami e ndoqi me bisht të syrit.

Kuestori u kthye e për së dyti vazhdoi ta pyesë:

— Pse bre dh mbas ushtarëve tanë?

Lami s'e priste këtë pyetje. Komolioja e pas-kësh ndjekur këmbë për këmbë.

— Unë këndoj me ushtarët, — kaq tha Lami.

Kuestori foli me qesëndisje:

— Prandaj ta kanë vënë edhe këtë emër: «La» dhe «Mi». Je i këngës, muzikant. Dy nota muzike i ke në emër.

U zgërdhi e u zgërdhi e pastaj prapë qëlloi, po fort. Ata sillnin sipas zakonit. Lami e kuptonte këtë dhe shtrëngonte dhëmbët.

Kuestori i zuri kokën me pëllëmbë dhe ja drejtoi nga vetja:

— Ej, tenore, na këndo një këngë!

Lami heshtte.

— Këndo!

Lami u skuq.

— Nuk mundem.

— Pse?

— Po si të këndo unë për ju?

Kjo s'qe përgjigje fëmije, prandaj kuestori erdhi në vete.

— Kush të ka mësuar të shposh goma?

Kësaj here qëlloi me kërbaç meshini.

Rrobat e bardha të kuestorit u bënë gjithë

njolla qymyri dhe, duke ju drejtuar serxhentit, urdhëroi:

— Dërgoja Veliut, atje të kalbet me të tjerët! Veli efendinë e pa në dritare, te kullat e burgut. Qëkur burgut i thoshin «Hapsanë», ai po drejtor kishte qenë. Veliu ishte trupshkurtër dhe i mufatur, me dy sy picërr me gjyslykë, shpirtzi. Lamin e shikoi që sipër e s'ju ndenj pa folur:

— E mre, biçimsëz, edhe ti qënke me të kuqtë? Eja në «hotel pa pare». Ja! Atje në kaush t'i shohësh të kuqtë! Kur të zënë yrysh ata tanksat e mi, ta marrësh vesh mirë bollshevizmin — edhe hi-hi-hi-hi-hi, ja dha një të qeshure të pështirë.

Në drejtori ja hodhën emrin në një regjistër të madh, pastaj e përplasën brenda.

Kapërceu nëpër dy dyer të hekurta dhe u gjend në pajtoz. Aty sikur u ndodh në lagjen e Xhaxhit. Sheshi i burgut që mbushur plot hasra dhe dyshekë të shtruar. Ç'qenë të burgosur rrëzë mureve, u mblodhën përçark Lamit. Ishin shokët e kishin demonstruar më tetë gusht.

Të gjithë u habitën:

— Me këtë ç'patën?

Pastaj shfrynë gjithë maraz:

— Fashistë të ndyrë! Edhe me fëmijët, o të poshtër?

Po Lamit s'i folën kështu. Lamit i dhanë zemër.

Gardianët s'e lanë të qëndrojë. E mbyllën në «selamllëk», *) siç thoshin ata me tallje. Ishte një qeli, që s'e rrihte dielli gjithë motit, veç ujë buronte dimër e verë. Aty patën lënguar sa e sa komitë e patriotë, aty i kishin përplasur edhe të

* Dhomë pritjeje (turqisht).

«rrezikshmit», që kishin udhëhequr demonstratën. Kur panë Lamin në kaush, ata mbetën gojëhapur. Mirë u vinte që e kishin në mes tyre, po ç'të gëzoheshin!

Atij sikur s'i kishte ndodhur gjë prej gjëje. Shtrëngo duart me njërin e përqafohu me tjetrin. Pastaj midis atyre shtresave të ndera në trokët i hapën një copë vend. Lami filloi të hapte sytë rreth e përqark. Mure të vjetër me gurë Zaranike, mure me gurë të zinj, që nxinin e djer-sinin. Tavani më pis. Po ju mësuan sytë shpejt në atë skotë dhe filloi të shikonte fytyra të çelura dhe të guximshme, prandaj dhe atij vetë i qeshi nuri dhe ja shtroi mirë bisedës.

Shokët zunë ta pyesnin, Lami s'u tregua as fjalaman, as mëndjemadh, tamam djalë i pjekur.

— Pse të kapën?

— Kot!

— Hë mor, tregona. Ne jemi shokë.

— Komolioja e pati fajin. Unë kërkoja topin nën maqinë, ai erdhi e më kapi. Ke parë kështu? Kot së koti!

— Çfarë Lami je ti? — u dëgjua zëri i një shoku.

— Të lumtë! Kështu duhet!

Pastaj ju afrua Sula, që pat punuar në fabrikën e cigareve.

— Ti mos u mërzit! Do të të nxjerrin me siguri! Se mos e more me kontratë?!

Lamit sikur i mbeti qejfi:

— Pse, po të më mbajnë, ç'do të bëhet? Mos mërziteni ju?

— Ooo, mos ma merr për keq! Mos ma merr për keq! Ne jemi shokë.

Të burgosurit e tjerë, që e dëgjonin këtë bi-

sedë, u këputën së qeshuri. Mbasi e sqaruan këtë mosmarrëveshje, Lami e Sula u miqësuan edhe më tepër. Sula i nxori drekë dhe përpiquej si e si që i vogli të mos e ndjente jetën e burgut. Pastaj i madhi i thoshte pionierit:

— Ti, Lam i vogël, mos kujto se jemi fare keq ne këtu. Kaushit tonë i kanë vënë lloj-lloj emrash, po ne as që duam t'ja dimë. Këtu vlon kënga si në asnjë vend tjetër. Edhe ty do të të mësojmë. A i di të gjitha këngët tona?

Lami numëroi: «Pararojën», «Barikadat proletare», «Malet me blerim mbuluar»... nja dhjetë.

— Po ti i ditke të gjitha! Këngën e «Tre heronjve të Shkodrës» a e merr dot?

— Nise një herë!

Sula këndoi strofën e parë.

— S'e kam dëgjuar. Vetëm këtë s'e di.

— S'kishe si ta dije. Tani sa ka dalë. Edhe ne këtu e mësuam.

— Kush jua mësoi?

— Ja, ai profesori me gjyslykë, — Sula tregoi burrin me të cilin Lami ishte përqafuar së pari, kur hyri në kaush. — Është shkëdran. Tre Heronjtë i pat njohur, ja kështu si njihemi ne të dy. Këtu e kapën, në demonstratë, atë ditë me ne.

— Do t'i thuash të ma mësojë edhe mua atë këngë!

— Ka për të ardhur vetë ai. Nuk përton. Gjithë burgut i ka mësuar këngë. Edhe ata në katin sipër, ordinerët *) kanë mësuar prej tij. Kënga është gjë e madhe. Atë e kemi armë, libër, ne këtu, me këngë u tregojmë njerëzve komunizmin.

*) Të burgosur jo për çështje politike.

Lami dëgjonte gojëhapur. Ai pat kënduar sa e sa herë, po që t'i shkonte mendja kaq thellë... Kurrë!

— Kur ne këndojmë, buçet burgu.

— Ju kam dëgjuar.

— T'i shikosh ata ordinerët, të gjithë dalin nëpër dyer e dritare dhe mbajnë veshët pipëz. Ne ua kemi dhënë me shkresë të gjitha këngët.

— Shumë mirë keni bërë! Po a këndojnë?

— Këndojnë dhe, veç kësaj, janë bërë njerëz. Shumë nga ata kanë hequr dorë nga veset. «Sa të dalim nga burgu, — thonë, — vrapin në mal do ta lëmë. Ja ç'bën kënga jonë.

Si u shty zhegu dhe ora shkoi si nja katër, të burgosurit u mblodhën top e trumbë në një cep të kaushit.

— Ti, komunist i vogël, eja këtu!

Lamin e vunë në mes.

Filloi mbledhja e grupit edukativ. Pionieri po çuditej. Ai shoku që foli, sikur të ishte lidhur me radio me të katër anët e botës. Në pëllëmbë të dorës e dinte situatën e jashtme dhe të brendshme.


Pastaj këngë. Në krye të grupit u vu profesori. Dhe Sula i shtyrë nga Lami, kërkoi që të nisnin me këngën e «Tre heronjve të Shkodrës».

— Posi, more! Çka t'i dojë zemra komunistit të vogël!

— Shiko, se djali s'e ka dëgjuar herë të tjera këtë këngë, — ndërhyri prapë Sula.

Profesori ndali një hop, pastaj ju drejtua të voglit:

— E mora vesh, po këtë këngë t'ua mësosh edhe shokëve!



— Po shoqeve, jo? Po gjithë Elbasanit? —
hodhi pionieri një shaka plot kripë.

Profesori nisi mësimin e këngës dhe veç me Lamin jepte e merrte. Ai i tregoi një herë ngjarjen në rrugën Firej. Kur fliste, buzët i dridheshin. Lami që ja kishte qepur sytë, vuri re se gjyslykët dalëngadalë po i merrnin shkëlqim. Po komunistët nuk qajnë. Dhe me të vërtetë, kur Lami kujtoi se ai do të shpërthente në vaj, profesori nisi këngën. Në fillim ngadalë, po te ajo strofa «Çka po thotë Perlati»... mori zjarr. U skuq fort dhe ju çua damari i ballit. Profesori nuk drejtonte më me dorë, po me grusht të shtrënguar, një grusht i rëndë, që dukej si prej plumbi. Atëherë ç'të dëgjoje? Buçiti i gjithë burgu. Këndonin kaushi dhe pajtozi: «Shokët dhe «ordinerët»:

*Mustaf Kruj tradhëtari,
shif si vdes shqiptari,
digjet bëhet zhari
për ide vatan.*

Ja merrte edhe Lami, në fillim me tralala, pastaj me fjalë. Apo nuk mësoheshin strofat e asaj kënge! Midis atij kori të zjarrtë e ndjente veten më të lirë se kurrë, ndaj, kur këndonte, tundte kryet herë më një anë, herë në anën tjetër, sipas ritmit të melodisë.

Kënga sa të nisë, po pastaj ajo përhapet si flaka. Dhe kjo kënga partizane ishte me të vërtetë flakë! Tek këndonin, të burgosurit s'donin t'ja dinin për hekura e mure, për gardianë e karabinierë. Në këto çaste ata të përpinin, prandaj ç'qenë roje nëpër burg, pa u ndjerë, dolën jashtë hekurave një

e nga një. Atëhere dyerve u vunë dryna të rëndë, në karakoll u dukën mitralozët. Po kush donte t'ja dinte?! Kënga mori hamull.

Në drejtori, te dritarja që shikonte mbi pajtoz, u mblodhën fashistët kokë më kokë. Veli efendiu sa s'po çmendej. Mori zilen e madhe të burgut dhe i ra e i ra sa u lodh. Pastaj karabinierët u frynë bilbilave. Po kush e shuante dot atë flakë?!

Në mbrëmje, kënga veç gjëmonte. Kuestori erdhi me ngut. Se ç'bisedoi me Veli efendinë në drejtori, po, kur mori vesh se Lamin e kishin mbyllur në «selamllëk», u bë xhind.

— Kretino! — Kretino! *) — uluriu disa herë.

Pastaj mblodhi buzë e dhëmbë. Me këmbë e me duar i spjegonte drejtorit:

— Po nuk e di, more, se gjithë këngët ai mistreci do t'i përhapë nëpër Elbasan. Apo do që kudo të bëhet si burgu yt!

Kuestori erdhi nja dy herë vërdallë.

— Si s'ta pret, more, si s'ta pret! — Dhe qëllloi tryezën me kërbag meshini. I kishin hipur.

Zbriti pastaj, duke thirrur me sa kishte në kokë:

— Të nxirret! Të nxirret! Në minutë!

Kështu doli Lami nga burgu, me gjoksin e mbushur gjithë këngë.

*) Budalla.

TIK FISHNJARI

Trakte ai ndante shpesh, kjo qe bërë punë e tij gjatë mbrëmjes. Frikë s'kishte fare. Shpesh binte rasti të shikonte burrat që e kalonin prakun e shtëpisë në mëngjez duke fshehur me kujdes traktin e partisë. Atëhere ngazëllehej.

Niste ndaj perëndimit, sa fillonte shtetrrrethimi. Rrugët boshatiseshin e kudo binte një heshtje varri. Ai s'donte t'ja dinte. Rojeve kishte mësuar t'u ruhej dhe as i bënte përshtypje zhurma e këpucëve të rënda gjithë gozhdë. Fletët e shaptilografuara i mbante në gji, të palosura katërsh, dhe i çonte derë më derë...

E përkëdhelnin duke e thirrur Tiku, se e quanin Petrit. Petrit me halle qe. Vinte i hajthëm, i thantë, po qe i shpejtë si fishnjar. Ku mbillej, s'korrej. Për gjysmë ore lagjen e mbushte me trakte. Një vit e vazhdoi atë punë dhe as miku, as hasmi s'e mori vesh se ç'bënte Tiku.

Shokët e qarkorit e njihnin të gjithë. E donin fort dhe bisedonin me të si me një djalë të rritur. Luftëtarët e shquar në qytet patën marrë pseudonime për t'ju fshehur armikut dhe Tikun «Fishnjar» zunë ta thërresin. Me këtë emër i vinin atë-

here nga «teknika e partisë» ato pusullat, që mbanin përsipër shënimin «tepër konspirative».

Sa kapitulloi Italia fashiste, gjermani e mbushi qytetin me tanke. Kjo ndodhi në shtator të vitit 1943. Tyta e topit, sa një oxhak fabrike, naltohej nga maqina e hekurt... e, për çudi, askujt s'i bënte tërr veshi. Nazisti s'kishte parë kokë shqip-tari. Armiku sa vinte dhe egërsohej dhe lufta jonë zuri të bëhej më e ashpër.

Tiku gjer atëhere i pat shpërndarë traktet, tani filloi ti ngjisë: në mure, në dyer në shtylla. Jo fletë të shaptilografuara, po komunikata e thirrje, të përgatitura në shtypshkronjën partizane të Çermenikës.

I ati, qysh në verë, e pat futur çirak te një shkarpaxhi. Simbas zakonit, Petriti e thërriste «ustai» këpucarin dhe ai qeshte, kur dëgjonte atë emër, se çfarë ustai ishte ai shkarpaxhi në atë çerte karaktinë. Ustai që me lëvizjen nacionalçlirimtare, ndaj shpesh i pëlqente t'ja merrte ulët ndonjë kënge partizane; atëhere e shoqëronte Tiku me zë të hollë... Tiku pat ngjeshur dhe përparse këpucarësh, me armë meshini në gjoks. Këtë rrobë e mbante gjithë krenari. I dukej përparsja simbol, që i falte emrin e nderuar të punëtorit dhe s'e hiqte as kur drejtonte gozhdë, as kur qepte sandale, as kur shkonte te «Porta e Kalasë» për të mbushur kotruven me ujë të ftohtë.

Një ditë, në çerte i çuan një pusullë. Mbi të qe shënuar: «Tepër konspirative — Fishnjarit». E kërkonin në një bazë ilegale. Letrën e binte Namiku i vogël.

Ustai buzëqeshi. E njihte Tikun, zgjuarsinë ja

çmonte, po, kur nisej për këso punësh, s'i rrihej shkarpaxhiut pa ja dhënë një këshillë: «Hapi sytë, Petrit, se është katil gjermani!»

Tiku u nis e, bashkë me të, Namiku. Ishin të dy shokë shkollë, po ky tjetri vinte si nja dy vjet më i vogël. Qe më i heshtur, po trim i zgjuar ishte.

Ka qenë tetor dhe rrugëve ngado gjeje feld-gjindarmë. Agjentët e Gestapos patrullonin nga dy. Mashinkat i mbanin krahaqafë, parzmoret prej metali dhe helmetat prusiane i tregonin dordolecë. Mbaheshin fort, çapin e hidhnin të ngrirë dhe shqyenin sytë. Pionierët u kaluan pranë, pa u hedhur asnjë vështrim.

Baza ndodhej në të dalë të qytetit, ku nisnin «Arat e gjata». Një derë e kishte nga çezma, dera e dytë të nxirrte në tjetër rrugë. Ata s'do të hynin nga dyert. Duhej të dilnin nga arat, të kaptonin gardhin e të futeshin në kopshtin e shtëpisë.

U futën në një ndërtesë të pambaruar, që binte në kopsht. Hynë në bodrum. Thasët sa po i kishin sjellë nga Çermenika. Qenë plot me trakte të shtypura në shtypshkronjën partizane.

Një shoqe e rinisë zuri t'ua mbushte shportën. Ndërsa ajo vendoste pakot, Tiku lexonte thirrjet e partisë, që mbanin poshtë fjalët: «Lexoje, shpërndaje dhe mos ja dorëzo armikut!» Traktet e gëzonin së tepërmi. Në shportë u futën dhe pako me afishe, që kishin lajmin e gëzueshëm: «Kievi, kryeqytet i Ukrainës, u çlirua!».

Mbi trakte, shoqja vendoste mushmolla dimërore dhe përsipër qepte mbas shportës beze të bardhë.

Materiali duhej dërguar në lagjen «Stalingrad».

Atëhere lagjen «Kala» të qytetit tonë e quanim «Stalingrad». Rrugët e saj të ngushta e gjithë dredha ishin foletë e njësiteve guerile. Atje i bënëin fëmijët planet e tyre të guximshme, atje Tiku u ndante shokëve pjesët e materialit sipas rrugëve, që andej, pasdreke, dhjetra fëmijë shpërndaheshin për të ngjitur trakte, në çdo skaj të qytetit.

Tiku pati mjaft punë atë ditë me shokët e vet. U ndante të gjithëve pjesët. Asnjë rrugë e qytetit s'do të mbetej pa trakte dhe afishe. Pionierët duhej t'u ruheshin mjaft rojeve. U nisën nga dy. Një të ruante, një të ngjiste. Kështu dhe do t'i shpëtonin Gestapos dhe punën do ta kryenin. Rrugët më të vështira i zgjodhi për vete, rreth e rreth lagjes së tij. Do të dilte në një udhëkryq, ku ishte vendosur postbloku, dy rrugët e tjera kishin disa shtëpi ballistësh, në fund do të kalonte nga «komandatura».

U nisën bashkë me Namikun: gjokset gjithë trakte, sapllaken me çirish. Dualën në udhëkryq: përballë rojeve. Dy gjermanë dhe një xhandar qenë dhënë pas kalimtarëve të rritur. Asnjëri s'ua vuri veshin. Dhe pionierët kaluan qetë-qetë, derisa u kthyen shpinën.

Kishte erë dhe nisi të vesojë shi. Mbi mure traktet s'ngjithnin, po mendja e Tikut shpikte. Nëpër shtylla qenë vendosur tabela dërrase, nga ato që tregojnë drejtimet e rrugëve. Mbi sfond gjermanët kishin pikturuar shqiponjën e Rahiut, me kryqin e thyer të Hitlerit. Në fund patën shkruar «Feldkomandaturë». Dërrasa qe e lëmuar dhe mbi të ngjiti si me tutkall afishen.

Shtyllat qenë mbushur me tabela e të gjitha i mbuluan me afishe. Mjaft ua kishin vrarë sytë ato zhgarravina gjermanësh!

Në rrugën tjetër u doli përpara një portë me qemer. Vinte pak i futur. Ishte derë beu me tri kanate. Pionierët muarën pak frymë, pastaj Tiku nisi shtruar t'i zbukurojë dërrasat e dyerve me trakte dhe afishe. Sa patën mbaruar punë, u hap kanati i vogël. Përpara u doli zonja, një piperkë që s'e kishte shoqen. Tikun e njohu dhe ju drejtua duke vjellë vrer. Gjithë rrugën e çuditi dhe kërkonte që fjalët e saj t'i dëgjonte kushdo, po gjerman nuk doli përpara. Një herë djali u step, po e mori shpejt veten, e bejlereshës ja mbylli gojën:

— Ti, balliste qepi buzët, se s'ta kemi qejfin! Mjaft ju kemi duruar! Po u rrezikova unë, të pret gjysma e lekut!

«Zonjën» e kapën ethet, seç mermëriti nëpër buzë dhe u fsheh shpejt mbas derës.

Pionierët s'e prishën gjakun. Vazhduan punën. Namiku ruante, Tiku ngjiste. Ata kalonin të qetë, sikur nuk po ndodhte asgjë. Kur u takonte të piqeshin me ushtarë hitlerianë, kalonin serbes e s'ua hidhnin fare sytë. Keq e patën në rrugën e komandaturës, po Tiku që bërë mjeshtër. Si pa të keq u afrohej shtyllave dhe mbasi ai largohej mbi dru ngelte trakti i partisë.

Para afrimit të mbrëmjes, ata e patën kryer punën. U patën tepruar disa afishe. I ruajtën që t'i kishin. Ndjenin një farë lodhjeje, po gëzimi që më i madh. Një ndjenjë burrërore ua mbushte zemrat: krenaria për detyrën e kryer! Fjalët e partisë u kishin dhënë krahë.

...Pionierët muarën nga «Stalingradi». Tek venin, takuan me shokë që i lajmëruan se nazistët kishin nxjerrë ushtarë nëpër rrugë që të hiqnin traktet. Tikut i ndërroi çehreja. Si bëri ca çape, pa

një hitlerian të shkurtër duke ngritur pushkën: hiqte me tytë traktet e vëna lart. Tiku sa s'plasi... Po afronte koha e shtetrrëhimit. U nda me Namikun, duke i dhënë zemër:

— Mos u dëshpëro, Namik, ne e bëmë punën tonë dhe e bëmë për mrekulli.

Vetë u drejtua nga postbloku.


Në udhëkryq po bëhej një rrëmujë. Kishte ardhur vetë Franci, shefi i Gestapos. U ckërmitej rojeve dhe ulërinte. Qe fryrë e qe skuqur, tamthat po i plasnin.

— Kështu ju pafsha! — murmuriti Tiku. — Do t'ju shkallojë Shqipëria. Po dale, se ka avaze puna!

Më tej feldgjindarmët po shqitnin afishet nga tabelat. Tikut sikur i shqitnin krahët.

Vendosi të presë. U fut midis hithrave në Beden të kalasë, atje e gjeti nata, duke përgjuar këmbët e rojeve. Qielli këtu vrehej, aty çelej. Errësirën dhe e donte dhe s'i pëlqente. Pionierët i kishin thyer me kohë llambat nëpër shtylla. Nata nxihej dhe bëhej e rëndë nga zhurma e patrullave.

Qetësia ra vonë. Atëhere nga Bokaniku u çua një vetull hënë. U ngrit dhe Tiku. Rrëshqanë zbriti gjer ku ngrihej muri i rrugës. U ngjit në mur. Me krah e këmbë shtrëngoi shtyllën e parë të elektrikut. U dha forcë këmbëve dhe trupi u ngjit përpjetë. Po ngjitej Fishanjari. Arriti nën harkun e llambës. Aty ndali. Nxori një trakt nga gjoksi, e mbështolli rreth shtyllës dhe i nguli thumba. Zbriti sa çel e mbyll sytë. Kaloi në shtyllën tjetër; sytë i kapën hënë, kishte bërë rrugë përpjetë. Po shtë dalloi një hije, po thumbat i nguli të katër. Hija lëvizti dhe diçka feksi mbi të. Atëhere Fishnjari zbriti. U dëgjua një fishkëllimë plumbi mbi kryet.



Tiku ja dha vrapit. Prapë krismë e fishkëllimë. Fishnjari u bë erë. U dëgjua pastaj zhurmë këpucësh dhe një pallë gjermani.

Tiku fluturoi dhe s'mendonte gjë tjetër veç të futej në Rrëpinë. Atëhere dilte në «Stalingrad» dhe kishte shpëtuar. I mblodhi të gjitha fuqitë e, kur mori kthesën, një fishkëllimë i rrënqethi faqen. Ai s'u ndal. Me një frymë zbriti Rrëpinën. Përpara dëgjoi bilbila rojesh. Më tej ishte burgu. S'duhej të çapte andej! Ktheu dhe doli te çezma. Aty ndodhej shtëpia e ustait. Në dritare dalloi dritë. Fryma po i merrej. U zgjat majë gishtash e trokiti. Kanatet u hapën e në çast nxori krye ustai:

— O Tik!... Ngjitu, Tik!

Fishnjari u kacavar ndër hekura të dritares. I hajthëm siç ishte, pa zor, u gjend brenda në shtëpi të këpucarit.

Pjestarët e familjes e rrethuan Tikun, po pionieri s'e kishte marrë veten nga lodhja. Plaka e shikonte mos kishte plagë.

Duke ardhur përçark, këpucari murmuriste:

— Ma ndolli zemra mua, që kur dëgjova pushkën e parë... Po ruaju, të shkretën!

— Epo dasmë pa mish nuk bëhet, o usta! — u përgjegj i vogli, që e kishte marrë veten.

Në rrugë u dëgjuan prapë zhurmë këpucësh të rënda. Vonë, jugu llamburiti: flakëronin depot në kazernat e Shkumbinit.

MERKUR PANXHI

Merkur Panxhin lufta e gjeti të shtyrë në mo-shë, po gjithnjë trupdrejtë. Mbi buzët, mustaqet i ndereshin si krahë të bardhë pëllumbi dhe flokët i qenë kthyer në bashkë rudeje dëbore të bardhë.

S'pati, as çun, as gocë, po zemrën e kishin plot; shtëpinë më plot: mbushur me vajza e djem luftëtarë.

Atëhere punonte në kopshtin e «Normales». Pëmët i donte si fëmijë. Kur frynte erë dhe shqyhej ndonjë degë, atij sikur i thyheshin krahët. Zanatin po ua mësonte normalistëve të rinj. Nga ana e tyre, ata i patën mësuar Merkur Panxhit aq sa s'pat ditur në gjashtëdhjetë vjet jetë.

Banonte në të dalë të qytetit, në një shtëpi përdhese me tri kthina. Bashkë me gruan mbante kuzhinën. Në dhomën tjetër jetonte shoku Spiro. Kundruall flinin normalistë.

Lufta po merrte hamull. Njerëzit po zinin krahun e tyre përballë flakës, që sa vinte e shtoej. Qëllonte që e pyesnin daj Kurin:

— Me cilët je, o Merkur Panxhi?

— Me çunat! *) — përgjigjej daj Kuri dhe ngrin-

*) Në Elbasan fjala «Çuna» u përdor gjatë luftës për pjesëmarrësit e Luftës N.Çl.

te pëllëmbën gjithë kallo. Pesë gishtat të hapur. Kështu e tregonte Merkur Panxhi yllin me pesë cepa të komunizmit.

— Kjo do të fitojë! Kjo! E kuqja!

Ata që e mbanin veten të matur e të pjekur e lëndonin:

— Po ty ç'të duhet?! Ç'i hyn kësaj valleje?! Çun s'ke, gocë s'ke! Nemelazëm? *)

Merkur Panxhi, burrë i urtë, dridhej këtu:

— Kam, ore, si s'kam? Një Shqipëri të tërë kam. Një rini. Qenka puna të kesh djem e vajza! S'kam ullishta për të lënë. Shqipëri të lirë dua. Shqipëri për fukaranë!

Mbas dhomave e mbas kuzhinës, shtëpia e Kur Panxhit kishte një qur të errët pa baxhë e pa dritare. Atë ua pat lënë çunave. Normalistët suallën aty një maqinë shkrimi nga Ushtrimorja, shaptilografin e prunë nga Normalja. Letrën e sillte shoku Spiro, nga Banka. Aty e kalonin natën çunat. Shpesh vinin dhe shokë të tjerë dhe atëhere e gdhinin. Në mëngjez, daj Kuri merrte rrugën për në kopsht. Thesin në krah e kishte polt me trakte e komunikata. Kështu niseshin për rrugë thirrjet e zjarrta të qarkorit, që shpërndaheshin pastaj kudo në qytet e jashtë qytetit.

Po se mos kryente veç këtë detyrë Merkur Panxhi! Një gjë dinte ai. Këto ishin punë me kokë në dorë, ndaj atyre luftëtarëve u rrinte po mbi krye dhe ndihnte me ç'të mundte. Kur djemtë punonin, ai rrinte e ruan. Qëllonte që natën e kalonte sipër fikut. Cigare nuk ndizte e qepallat s'i përpiqte një herë. I mbeteshin sytë gjithë natën rrugës. Meraku i brente zemrën që ai mur i avllisë s'i pat ndodhur i

*) Turqizëm — Ç'më duhet?!

lartë. Aty mes degëve, duke ruajtur djemtë, ai ëndërronte atdheun me diell, Shqipërinë e çunave. Merkur Panxhi, që s'u pa viteve një ditë të bardhë, si i dëshëruar ëndërronte që të rinjtë ta gëzonin jetën nën dritën e kuqe të yllit me pesë cepa... dhe vetë ai s'kishte as djalë, as vajzë.

Një mëngjez e ruajtën mbas kopshtit të Normales. Përpara se të hapte derën, ai duhet t'i kishte hedhur një herë sytë rrotull. Po ta kishte bërë këtë, do të dallonte mbas gjerdhesh një togë policësh fshehur e tulatur. Kur hapi derën e bëri të ecë me thes krahëve, e mbërthyen dhjetra duar dhe ajo urë dërrase e kopshtit mirë që s'u shemb. Thua se kaluan hamshorë përrallash mbi të.

— More, po hiqmoni! — thirri Merkur Panxhi dhe bëri t'u shpëtojë. Veç kjo punë s'bëhej në ato çaste.

Atëhere daj Kuri pyeti:

— More, po thomëni një herë ç'doni?

Qe hutuar dhe s'e kuptoi që thesin ja kishin rrëmbyer nga krahët. Ata ja nxuarën para syve dhe u munduan të tallen me të.

— Këto deshëm, — dhe i treguan traktet.

Merkur Panxhit ju ç'a zemra dysh dhe qau me vete:


— Bobo, traktet e djemve! Bobo, që u këputën çunat e dajës! Bobo!

Si në moshë, diti ta mbledhë veten:

— Epo, ç'janë ato?

— Ç'janë këto, ë? Ë ë ëh, ç'janë këto?! S'i ditke, ë? Hë, se ta tregojmë ne!

Shumë grushte e dërmuan dhe e çorrën. Flokët, si bashkë rudeje, mustaqet si krahë pëllumbi, vetullat e thinjura ju ngjyen me të kuq. Qielli i ra



mbi krye dhe bota ju errësua. Kush pat guxuar ta prekë ndonjëherë Merkur Panxhin?!

Kur sytë po i çelëshin, përpara i doli Xhema i vogël. Në fillim i pa damarët mbi tëmtha, pastaj ju çfaq një hundë e mavijosur pijaneci, që shfrynte grahmë rakie.

— Ç'e ngatërron veten në këso punësh, o Merkur?

— More, nuk po marr vesh se ç'kini, — tha kopshtari si i hutuar.

Xhema vazhdoi:

— Ç'të duhen traktet ty? Pse fëlliqe në pleqëri?!

Kur Panxhi sikur u shushat.

— More, po ç'janë traktet, se po më habitni?!

— Ç'janë traktet? Po ja, more, gjithë ky thes me trakte është mbushur. Me çfarë është mbushur tjetër? Pse shtire i habitur dhe ti?

— Hej, ç'po më lini pa mend e pa gojë! S'di gjë, ore, për këta sy! Në rrugë, ore, m'i dhanë, që u qorrofsha.

— Kush t'i dha, — pyeti në çast Xhema.

— Katundar që ai që m'i dha. Me qeleshe.

«Mbaji», — më tha, — «se vi e i marr më vonë». Sa lenë plaçka në këtë kopsht?!

Xhema u mpreh:

— S'e njeh ti atë katundar?

— Hiç fare!

— Për t'u çudit qenka!

Oficerit italian s'po i durohej. Xhema zuri t'ja shpjegojë ashtu shatra-patra. Po oficeri që nga të SIM-it e s'gënjehej, ndaj e shembi Xhemën e vogël.

— Brigant! — ju çor fashisti daj Kurit. Ç'ish-

te kjo fjalë?! Merkur Panxhit s'i bëri përshtypje fjala, ndaj dhe e qëlluan fort me kondak.

Urdia u vu pastaj në lëvizje.

— Në shtëpi! — urdhëroi oficeri.

Për në shtëpi kishte dy rrugë. Kopshtari nisi të mendohej:

«Në shkofshim arave, atëhere, vaj medet!»

Po italianëve s'ua mbajti andej. Shkuan rru-gës e rruga qe gjithë njerëz. Do të gjendej ndonjë për të lajmëruar çunat, ndaj dhe Merkur Panxhi këmbët i hiqte zvarrë-zvarrë.

Për maqinën e shkrimit dhe për shaptilografin nuk vuri hall. Çunat i fshehën mirë, si mba-ruan punë, dhe, aty ku i futën, s'i gjente kush. Daj Kuri vriste mendjen për Spiron. Sa e dër-monte halli i Spiros! Ai dilte vonë në zyrë. «Sikur ta gjenin aty? Sikur ta gjenin? Veç ajo mos ndodhte!»

Një mendim i shkonte, një i vinte. Merkuri po buçiste.

Xhema rendte gjithnjë përpara... U duk çez-ma, u duk dhe shtëpia. Kopshtarit i shkrepiti të thërrasë. Të klithte me të madhe e të dëgjohej de-ri larg në shtëpi. Në do të ishte Spirua, mur më mur e gardh më gardh do të shpëtonte patjetër. I erdhi zor një herë. «Turp nga bota! Do të tho-në kaq e pat dhe Merkur Panxhi». Po zorin e kap-toi e turpi s'ishte turp. Aty pranë shtëpisë zunë ta shtyjnë me kondakë. Ai thirri. Po ç'të thirrur!

Veten s'e shpëtonte lehtë, po Spiron duhet ta shpëtonte. Këto mendonte, kur po futej në shtëpi. Të shoqen e gjeti buzë hajatit, më burrë se bu-rrat. Ai ja mbërtheu sytë. Ajo s'vonoi t'i përgji-gjet. Me vetulla i tregoi se Spirua ishte larguar.

«Shpëtoi çuni, kjo është e gjitha». Vetën s'e llogariste. Ç'do t'i bënin? Merkur Panxhi u bë më i fortë dhe më i vendosur.

Oficeri dhe policët kërkuan. Panë edhe hatullat, shqyen edhe dërrasat e dyshemesë. U mbushën gjithë blozë e gjithë pezhishka, po s'gjetën gjë prej gjëje.

Pastaj prapë vunë Xhemën të pyesë:

— Ku shtypen traktet?

— Jua thashë, nuk merrem me aso punësh. Sa për mua, atë ma dha katundari.

Në sy të gruas ata s'e qëlluan. Oficerit s'i pëlqeu ajo përgjigje, ndaj e kurdisi prapë Xhemën dhe pijaneci filloi:

— Ku gjendet maqina? Ku e mbani letrën?

Merkuri habitej dhe rrudhte krahët. Italiani kërciste dhëmbët. Xhema pyeste, pastaj e kishte radhën Merkur:

— Shpirt kam, maqinë s'kam. Doni shpirtin, ja ku më kini. Ma merrni. Maqinë s'kam.

— Kush i bën këto, ne e dimë. Prandaj trego. S'i ke as djem as nipa.

— Nuk është aty puna, po kaq dita, kaq thashë!

— Je plak e mos u fëlliq! Mos shko «bedel»! — e këshilloi spiuni.

Oficeri bëri të ndezë cigaren. Shkrepi çakmakun dhe ndali. Zjarrin s'e shoi. Me çakmak në dorë ju afrua Merkur Panxhit e nëpër dhëmbë po i shpërthente një zgërdhimë.

Asnjë s'po e kuptonte ç'i kishte pjellë mendja fashistit. Daj Kuri po e ndiqte me sy dhe ja ndolli të keqen. U bë prush dhe avull po i çohej nga koka. Oficeri u mendua t'ja vinte çak-

makun mbi buzë. Ku e kishte hallin ai, ku e kishte?! Po s'e la Merkur Panxhi. Me frymë e me pështymë ja shoi çakmakun.

Italiani u mundua së dyti t'i djegë ata krahë pëllumbi mbi buzë të kopshtarit. U afrua sërish, duke murmuritur sikur mbllaçitej:

— **I baffi! I baffi sporchi!***

Policët qeshnin mbas ustait, po nuk ndyeshin lehtë mustaqet e Merkur Panxhit dhe s'mund të tallesh me një shpatarak, prandaj ndodhi ajo që ndodhi. Ai plak gjashtëdhjetë bukësh e përmbysi oficerin dhe do t'ja kishte marrë shpirtin, ja ashtu me shqelma, çka që duart ja kishin lidhur. Një togë policësh ju hodhën mbi kurriz, po ai, si xhind, diti t'i ndajë e t'i përçajë e vetë përmbys nuk ra.

..Mbas gjithë këtyre, fashistët ja bënë dajë Kurit atë që deshën. Deri në Tiranë e dërguan, drejtë e në gjykatë ushtarake. Atje e dënuan jo pak, po plot me njëqind e një vjet burgim. Se mos u tremb plaku. As deshi t'ja dijë. «Shpëtuan çunat, kjo është gjithë puna, po njëqind e një vitet as njëqind e një ditë s'do të bëhen». Këtë e dinte mirë Merkur Panxhi.

Ashtu ndodhi vërtet. Në mes të shtatorit veç kur ta shihje daj Merkurin me dengun krahëve drejt e në shtëpi. Po s'e deshi atë farë lirimi ai kopshtar zemërmadh. Takoi të shoqen dhe ajo i doli përpara, e prerë, thua se nuk po e gëzonte lirinë e burrit. Ai po rrinte aty buzë hajatit mbi deng. Hodhi sytë mbi kreca e shefteli. Portoka-

*) Mustaqet, mustaqet e fëlliqura (it.)

Ilet i kishin rritur kokrrat dhe gjethi u shkëlqente. Ju bë qejfi dhe mendoi mirë për të shoqen, pemëve u kishte lënë zot. Po kishte njëqind e një ditë i larguar. Asgjë s'dinte për çunat e për luftën, prandaj e pyeti të shoqen gjithë ankth:

— Moj, po çunat si janë! Spirua nga bëhet?

Më mirë ta vrisje plakën, se sa t'i bëje këtë pyetje, ndaj vinte rrotull. Gjithë ato ditë sa përpjekje qenë bërë, sa luftime patën ndodhur! U vra dhe Spirua në Pojskë bashkë me Reshitin. Plaka i vuri zemrës gur dhe u përgjegj:

— Spirja na u vra, o Merkur! E vranë dushmanët buzë gjolit të Pogradecit... dhe nuk mundi të vazhdojë më gjatë, po ja dha vajit.

Merkur Panxhi nxori vetëm një ofshamje:

— Oooh, Spirja i dajës!

Zemra e plakut u bë lungë. Zuri t'i çajë e t'i therrë e pastaj i rëndoi si plumb mbi lukth. Qendroi buzë hajatit, po mbi deng, dhe fytyrën e mbështolli mes dy duarve.

Mbas kësaj dite as u pa më në Elbasan, po shkoi e u rreshtua në Brigadën e Dytë dhe luftoi me çunat për Shqipërinë dhe për yllin me pesë cepa.

LEKUA I TELO RRAPIT

Një pikë burrë i gjatë ky Lekua i Telo Rrapit, shtati këtu e në tavan! Edhe pse vitet ja kanë kthyer nga përpara kurrizin, prapë duket se ç'Leke ka qenë.

Zanat nuk la pa bërë sa qe i ri. Ku ta doje e gjeje, në daç si millona e në daç si murator, po asnjëherë s'i pat ecur mbarë, derisa më në fund qe katandisur bravarexhi.

Kur bie sot në bisedë me Lekon, të thotë se si në dyzetedy, një ditë korriku, atje, në pyllin e gështenjave të Plesatit, qe takuar me Çalon e Fushëbardhës.*) Pastaj tregon se si ka ngrënë bukë e kripë me Muzon*) e me Asimin,*) po qejf të madh ka Lekua të flasë se si, me batalionin teritorial të Çalos, kishin sulmuar fashistët italianë në Urë të Kardhiqit, të cilët e kishin lënë vrapin te Plepat e Dinos.

*) bravarexhi = bari që kullot bravaret, delet shterpa.

*) Çalon e Fushëbardhës = kështu e thërrisnin Karafil Bellon, komandant partizan i batalionit teritorial të Kardhiqit.

*) Muzua = Muzo Asqeriu, dëshmor i Luftës Nac. Çlir.

*) Asimi = Asim Zeneli, hero i Luftës Nac. Çlir.

Mbas çlirimit qe shpërngulur Leko Rrapi në Dhoksat. Atje ku ishte më parë postëkomanda, ngriti shtëpinë e re. Këshilli e rregulloi në mullirin e Rrashanit e, që nga ajo kohë, u rrit nami i Lekos si millona i dorës së parë.

Me të rënë dielli në Mal të Gjerë, arriti Vitua e Kiço Lipës. Kishte vënë mushkën përpara dhe djersët i shkonin çurg.

Qe një grua trashaluqe Vitua e Lipajve; fshati e kishte në gojë për të keq: s'pat lenë shtëpi pa grindur.

Kiçua u syrgjynos në Amerikë këtu e shumë vjet përpara. Për vite të tëra s'u dëgjua Kiçua, po se ç'i hipi atë mot dhe zuri i mërguari i Lipajve të na dërgonte dollarë dhe letra me gjithfarë fotografish. Që nga ajo kohë zuri të ngrihej Vitua, të ngatërronte botën e të fliste keq për këshilltarët gjoja qenkeshin axhaminj.

Fshati qe çuditur një herë për nikoqirllëkun e vonuar të Kiços, po Foto Qapja, që la dy fije brinjë në kasaphanat e Çikagos, ta priste ashtu pleqërishte:

— E ku të lenë misterët të pasurohen Kiçorët, janë dallavere të politikanëve të Amerikës këto! Dhe prapë e vinte dorën në mes, si bënte ngahera për të lehtësuar plagën e vjetër që kishte marrë në djalëri.

Lekua atij mëngjezi sa kishte hedhur barrën e parë në koshere. Aty, në një anë të mullirit, digjeshin ca urë.

Nga barrët e shumta nuk pat vajtur në shtëpi atë natë, kishte punuar deri gjer më të gdhirë. I kërrusur qe, duke mbledhur miellin e shpërndarë, as që vuri re ardhjen e Vitos; vetëm e dë-

gjoj kur ju afrua mbi krye dhe e përshëndeti me një zë plot qesëndi:

— Mirëmëngjez, more zoti Leko!

Lekua ktheu me ngadalë fytyrën e zbardhur vende-vende nga mielli dhe, duke qeshur, ja priti:

— Mirëse na urdhërove, moj kako Vito.

Asaj i erdhi keq për këtë ofiq që i dha Lekua dhe sikur ta kishte përgjigjen në majë të gjuhës, duke tundur e shkundur trupin si të buallcës, ja priti:

— Mos më thuaj kako,*) more Leko Rrapi, se jam vajza jote!

Lekua u ngrit më këmbë dhe, me gjallëri, sikur të ishte njëzet vjeç më i ri, shkarkoi mushkën me ndihmën e Vitos, që mbante anën. Si i peshoi barrët në kandarin që varej mbi tra, i vendosi thasët mbi një gur mulliri të thyer përgjysmë, që ishte pranë kosheres.

Lekua mori lopatën e vogël në dysht*) dhe zuri të mbushë thesin me miell, Vitua mori një stol dhe u ul pranë tij. Nxori lëmshin nga prehëri dhe zuri të thurë çorape. Po prapë nuk ju ndenj dhe shpejt filloi bisedën si larg e larg:

— Ja hodhe fukarallëkut tani, more Leko.

Ai s'e kuptoi ku rrihte Vitua, andaj u përgjegj me të vetën:

— E po ç'të bëjmë, moj Vito, dhe ata dollarët e Kiços lipsur qofshin! U syrgjynos nga shtëpia dhe çoj ka nisur e bën tani andej. Farmak u bëfshin dhe ata!

*) Kako = në Lunxhëri, me këtë ndajshtim thirren gratë e moshuara.

*) Dysht = arka ku derdhet mielli që del nga gurët e blojes.

— Mos u fry si qumështi, Leko, s'e kam aty ku kujton zotrote. Po tani me të vërtetë shpëtove; vetë në mulli, Pilua shofer. Djalin e vogël në shkollë, ja dhe vajza mbrëmë t'u shkrua në kursin e infermiereve. Lum si ti!

Këto fjalët e fundit s'i tingëlluan mirë Lekos.

— Për ç'vajzë më thua, moj! — pyeti i vrënjtur. Pastaj rrudhi sytë, sikur donte të sillte ndërmend ndonjë ngjarje të vjetër dhe kërkonte në kujtesën e tij vajzën, që ishte shkruar në kursin e infermiereve.

— Për Katon, more! S'e mësove që Katua u shkrua mbrëmë në kurs? — Dhe pastaj, me atë gjuhë si shpatë, filloi të tregojë si u mblodh në shkollë rinia e Dhoksatit, si kishte ardhur një i deleguar nga Gjirokastra, pastaj i tregoi Lekos se si në fund të mbledhjes u shkruan për në kurs vajzat e Kolejve, Ngjelina e Mitro Stojës dhe Katua.

Ndërsa Vitua fliste, Lekua dëgjonte duke i bërë sytë katër dhe duke e përqëndruar gjithë vëmendjen te fjalët plot helm që i dilnin asaj gojëprishure. Pastaj e mbuloi me një varg pyetjesh: si ndodhi e kur ndodhi kjo gjë, dhe Vitua nuk përtonte t'i ujdiste përgjigjet si ndonjë magjistare.

Lekos nuk i pëlqeu kjo bisedë. Ndenji ashtu pa folur, duke vënë njërën dorë nën mjekër dhe tjetrën mbi gjunjë e u kredh në mendime të thella. Vitua, që e vuri re këtë, nisi prapë nga e para:

— Pse shtie hall, more Leko ziu, vajza për botë rritim tani. Ç'u bë, u bë. Mos të ka ngjarë vetëm ty kjo. Sa vajza kanë shkuar atje, kanë marrë dhe burrat vetë e prindërit nuk kanë bërë si zotrote.

Lekos i ranë thikë në zemër ato fjalë, gjaku ju ndez dhe foli me inat:

— Mbylle gojën, se nuk kam aso vajze unë,
— sytë i nxuarën shkëndija dhe nofullat i dridheshin kur shqiptonte fjalët.

* * *

Si iku Vitua, mendimet e mbytvn Lekon, jo për gjë tjetër, po më shumë se kjo mesele që doli tani, ja prishi të tëra planet. Këtu e disa vjet përpara, kur erdhi për herë të parë në Dhoksat, «gjë s'të shkul kënde», — tha me vete. Dhe me të vërtetë, ky Dhoksati i bukur rreth e rreth me bahçe e me pyllin pranë, me tri palë kroje, ku të prehet shpirti gjithë pranverës nga bilbilat, s'le njeri pa mahnitur.

Vajza e madhe ju martua në fshat. Pat ndarë e çarë një gjirokastrit me mblesë e miqësi ta bënte nuse për djalin e vetëm, se vajzat e Lekos ishin me nam në tërë Dhoksatin si zonja shtëpie. Po hajde e mbush mendjen e tij: «Jo, mor, jo, e dua ta kem pranë», — u thoshte, dhe ashtu u bë. Sa për Katon, pat menduar ndryshe: «Do ta mbaj në shtëpi», — pat thënë. — «Mbase gjen ndonjë burrë për të qenë». E donte me kokë vajzën e vogël Lekua. Po këtë punë donte ta bënte dhe për inat të djemve, që nuk ndenjtvn t'i trashëgonin zanatin.

Kur mori patentën Pilua, më çapkëni i djemvet, i pat shkruar: «Si të ngremë kooperativën, do të vi të punoj shofer në fshat, që t'i pëlças kulakët!» Po Lekua pat murmuritur po të parën: «Jo, more, jo, nuk mendoni për Lekon më ju, një Kato është ajo që e ka mendjen te babai».

«Po halli tani! Kjo që befti ç'qe?!»

Mendohej Lekua mbi dysht dhe lopatkën s'e lëshonte nga dora. Mokrra vërtitej më të thatë dhe bënte një zhurmë të papëlqyer, po ai s'e kishte mendjen aty.

Më në fund ndau të nisej për në Dhoksat. «Ta marrim vesh një herë se ç'bëhet». Ndali mokrrën, vuri kasqetën në kokë, mori bastunin, që s'e largonte nga vetja, dhe, si kyçi derën, u vu për rrugë.

Menjëherë u gjend në fund të Pllakës. Kur po ngjiste të përpjetën, i kujtoi dhe një herë fjalët e Vitos dhe zemra ju lëndua.

Tërë rrugës vriste mendjen të gjente si qe e mundur të shkruhej Katua pa lejen e babait në kurs. «Ah, Kato, Kato, ç'më bëre!»

Këto i vërtiteshin Lekos në kokë derisa kaptoi përroin, që ishte tharë nga vapa e gushtit. Në të hyrë të fshatit, pyeti disa gra, që takoi poshtë Bregut të Lëmenjve:

— Mos është në fshat ai i deleguari, që ka ardhur nga Gjirokastra, o motrani?

— Atje është, xha Leko, te bendi*) e gjen, — ju përgjegj më e reja ndër to.

E ndali pak çapin atëhere. Te kroi i Çajkës piu ujë me etje të madhe. Rruga e pat ndezur, po kjo Çajka e shkretë të shëron në verë.

Kur zbriste tatëpjetën, Lekua dalloi rrëzë murit të bendit, në hijen e fikut të egër, dy vetë. Kishin qëndruar mbi gurë dhe, nga lëvizjet që bënin, dukej se bisedonin gjëra me rëndësi. Atë më të gjatin e njohu që ishte Miho Veshi, krye-

*) Bend = rezervuar uji pranë çezmave të fshatit, përdoren për ujitjen e kopshteve pranë.

tari i këshillit. Atë tjetrin s'e kishte parë ndonjëherë, po e mori me mend se ishte i deleguari. Ishte një djalë zeshkan ky, me një palë vetulla të trasha, që i piqeshin mbi hundë. Deli djalë ju duk një herë, po kur i pa çantën që mbante pranë, s'ja mbushi synë. Qe zemëruar një herë Lekua me një nëpunës të mullinjve, që mbante çantë të madhe, dhe qysh atëhere i pat marrë zët njerëzit me çantë.

Duke u afruar, zuri të përplaste më me forcë shkopin, sikur e bënte ta dëgjonin ata, që ishin ulur rrëzë bendit.

Mihua dhe i deleguari u ngritën në këmbë, me t'u afruar Lekua.

— Mirëdita! — i përshëndeti duke çikur strehën e kasketës.

— Mirëdita, xha Leko! — ju përgjegjën Mihua dhe i deleguari.

Të deleguarit në fillim i ndënji pak si rëndë, ca nga çështja e vajzës, ca nga ajo e mallkuara çantë.

— Pa merr një cigare, xha Leko! — foli i deleguari duke i zgjatur paqetën.

— Faleminderit, more djalë! — u përgjegjai, duke marrë cigaren. Pastaj nxori kutinë e tij dhe ua zgjati miqve.

Kur ndezën të tre cigaret, Lekua çeli bisedën:

— Ky shoku me ç'punë merret? — pyeti ai Mihon.

— Është sekretari i rinisë së rrethit, — shpjegoi kryetari.

— Gëzuar qofsh, more djalë! — i foli Lekua

të deleguarit. — Po nga ç'familje jeni nga Gjirokastra?

— Jam nga Mashkullora, — foli djali me një zë të ngrohtë, që të bënte për vete.

— I kujt nga Mashkullora?

— I Premto Shkurtit.

— Djali i Premtos, ti?! — pyeti Lekua duke hapur sytë. — Ti je Çakua?! Ua, ua! Sa qenke bërë, more djalë?!

Pastaj, si miq të vjetër, rrokën duart. Po Çakua nuk po e kuptonte mahnitjen e Leko Rrapit.

— Me babanë tënd, more djalë, — filloi Lekua, — gjë s'na ndante. U njohëm kur ndreqeshin sarajet e agallarëve, në Zhulat. Unë përzieja llaçin atëhere dhe Premtua e mbarte. Po na thithi të gjallë ujku i Zhulatit. Dy lekë në ditë na paguante dhe shëllira e vjetër na griu zorrët, po hajde e folë. Qe Mersin agai asokohe zot në tërë Kurveleshin. Deputet i Zogut, more, s'i thoshin shaka! Na treti puna atje! Premtua sa nuk plasi, unë dhe më keq. Iku pastaj në Amerikë. «Rri, more Premto!», i thosha. «Ç'të duhet Amerika, më keq është dhe atje». S'më dëgjoi. Iku. E mësova mbas dy vjetësh që e kishte zënë mali në mademet e Kalifornisë. Qava si çilimi, po ç'e do, vajti i ziu Premto. — Pastaj i hodhi dorën mbi supe Çakos dhe zuri t'ja rrihte me dashurinë e një ati.

Siç ishte ulur rrëzë bendit me të deleguarin dhe Mihon, Lekua i bëri zë së shoqes. Në dritaren e shtëpisë, mbi krua, doli Lekja.

— Kush foli? — pyeti ajo, duke zgjatur zërin, siç bëjnë gratë e Lunxhit.

— Kemi miq sot për drekë, — e lajmëroi.

E shoqja u fut brenda.

Kur u nisën për në shtëpi, te kroi, Lekua i foli dhe një herë Çakos:

— More Çako, hiqma vajzën nga defteri! Nuk kam vajzë për infermiere, ore! Axhami ajo. S'ka mbushur të katërmbëdhjetat. Pastaj, a e ke parë se ç'trup ka? S'tregon as për dhjetë. — Këtu Lekua i mëshoi zërit, po edhe vetë nuk dinte çfarë shkaku të gjente që dhe vajza mos t'i largohej dhe me djalin e mikut të mos e prishte.

— More xhaxha, ne mendojmë gjithnjë për të mirën e vajzës, mendojmë edhe për të mirën e fshatit, na duhen infermiere, — arësyetoi Çakua.

Lekua sikur u bind, po mendja s'i qe mbushur. Andaj, si bëri disa çape, e zuri Çakon ashtu si mënjanë dhe i tha:

— Lerma vajzën, Çako! Jemi dhe miq, fundja!

— More xha Leko, — nisi Çakua, — vajza me zor në kurse nuk shkruajmë. Jot bijë ka qejf të shkojë. Atje do të bëhet e zonja e vetes.

Ata vazhduan të ngjiten përpjetë sokakut në heshtje, derisa arritën në shtëpi. Te dera i priste Lekja. Si përshëndeti mysafirët, plaka zemërbar-dhë u priu në dhomën e miqve.

Dhoma e miqve ishte për merak. Katua, me duart e bardha, kishte vënë perdet nëpër dritare, të prera e të qepura mirë e bukur, kishte rregulluar jastëkët e qëndisur plot lule që kënaqnin ç'do njeri.

Po vërejtjen e njerëzve, që hynin në atë dho-

më, më shumë se çdo gjë tjetër e tërhiqnin dy fotografitë e Pilos.

— Ja shoferi, ka dalë si karagjoz, — tregoi xha Lekua.

Me të vërtetë, në të dy fotografitë Pilua të bënte të qeshje. Në njërin kishte marrë një pozë në këmbë, kapelen kthyer mbi sy, duart në brez, i kapardisur që ç'ke me të. Në tjetrën kishte nxjerrë fytyrën plot të nxira nga poshtë automobil, ku ishte futur për ta riparuar.

Si panë fotografitë, miqtë u ulën nëpër shilte, po xha Lekua s'u çeli më bisedë për djalin çapkën.

Biseda u vërtit pastaj sa andej këndeje, po prapë-seprapë erdhi te çështja e Katos.

— Ç'thua, Leko, do ta lesh me gjithë zemër Katon të niset me shoqet? — pyeti Mihua.

— Si t'ju them, more djema? — foli ai duke tundur kokën.

Pastaj, si u mendua dhe ca, vazhdoi:

— Ajo le të bëjë si të dojë! Unë, sa për veten time, nuk i jap leje.

Katua që dëgjonte nga pas derës, u fut në dhomë dhe ju shkreh të jatit:

— Pse s'më le, ore baba? Pse s'më le?! — Dhe lotët e mbytn.

Qe e para herë që fliste kështu me babanë Katua.

Lekja, që kishte dëgjuar zërin e së bijës, u fut në dhomë dhe ju drejtua të shoqit me inat:

— Pse ja prish qejfin vajzës, more burrë? Lere, more, të shkojë me shoqet! Pse u bëre katal tani në pleqëri? Vëri, more, gishtin kokës!

Lekua e humbi, po më tepër i erdhi turp nga miqtë. Gjithë inatin e pati me të shoqen dhe ju drejtua asaj me duf:

— E di unë, e di kush i bën këto! Ti, moj zonjë, ti! Ta ka ënda të kapardisesh.

Pastaj i foli së bijës me zë të ftohtë:

— Ikë! Ikë!

Këto fjalë tha Leko Rrapi atë ditë në mes të miqve, duke i dhënë së bijës, me gjysmë zemre, lejen për të shkuar.

* * *

Aty në të hyrë të vjeshtës së parë, një javë pas festës së Lunxhërisë, u nisën vajzat e Dhoksatit për në kurs. U nis dhe Katua, po i ati nuk e përcolli deri në Gjirokastër, siç bënë prindërit e tjerë për bijat e tyre. Lekja s'ju nda së bijës deri sa hipi në autobus.

— Udhembarë, Katua e nënës! Ruaj shëndetin! Të na nxjerrësh faqebardhë! — i tha kur u nis, dhe lotët ju rrukullisën nëpër faqet plot rrudha.

— Pse qan, moj Lekë? — e kishte pyetur Mitro Stoja, që kishte dalë dhe vetë të përcjellë të bijën.

— Pse të mos qaj, o Mitro? Të gjitha vajzat i përcuallën baballarët e tyre, vetëm ime bijë iku si jetime, — dhe prapë i kishin rrjedhur lotët.

Si iku Katua, në shtëpinë e Rrapajve filloi grindja. Për gjashtë muaj me radhë Lekua sa nuk

i hëngri shpirtin së shoqes. Gjithëfarë mendimesh i shkonin atij nëpër tru. Kujtonte bisedën me Viton dhe sillte ndërmend fjalët e papa Nestit të Gjatit, që i kishte thënë një ditë në mulli:

— Deri më sot Lunxhëria s'i ka dalë nga vija ungjillit. Djemtë, ngadoqë kanë vajtur, janë si janë, po prapë në besën e tyre kanë trokitur. Të shohim vajzat tuaja ç'do të na kërrejnë.

Këto sillte ndërmend Leko Rrapi dhe i bëhej se tani që vajza i qe larguar, do ta zinte burrin përkrahu. E çfarë burri se!

Me këtë mendje vinte natë për natë në shtëpi dhe i derdhej së shoqes:

— Ti e nise vajzën në kurs! E paç më qafë, e paç! Rri tani e dëgjo fjalët e botës?

Andej nga çeta *) e poshtme vazhdonte avazi:

— Dërguan vajzat në kurs për t'u gjetur burra! — bluante Vitua.

Dhe plakat ja mbanin:

— Po ai Leko ziu, moj, paska qenë për t'u lidhur.

Të tëra këto i binin në vesh Lekos dhe për të gjitha i shfrynte së shoqes.

Në të hyrë të pranverës, Katua i shpeshoi letrat. Në letrat e fundit ajo shkruante për sukseset në mësimet dhe u tregonte prindërvë si ja kishte marrë dorën zanatit.

Lekua nga këto punë nuk kuptonte shumë, prandaj nuk e dinte se ç'kapedane po i bëhej e

*) Çetë = çetë i thonë lagjes në Lunxheri.

bija. Sa për Leken, ajo kishte filluar ta mburrte vajzën në çdo muhabet që binte.

Një mbrëmje erdhi postieri. . . Ishte në të ngrysur. Ai hyri drejt e brenda dhe i gjeti aty burrë e grua.

Kam sjellë një zarf të trashë sonte, dhuratë për xha Lekon, — tha ai, pa i përshëndetur ende. — Për mirë qoftë! — u përgjegj Lekua.

Postieri u dha zarfin. Lekua nxori një letër nga vajza, një fletëlavdërimi dhe një shkresë nga drejtorja e kursit.

Miku ndërhyri, rrëmbeu nga duart e Lekos fletëlavdërimin dhe ja afroi në fytyrë.

— E, Leko Rrapi, e dallon këtë? E di ç'është?

Lekua hapi sytë, po nuk shihte në dritën e pakët të llambës.

— Afroje, moj grua, atë dritë këtu! — i foli së shoqes.

Lekja mori llambën dhe ju afrua të shoqit. Të dy, burrë e grua, shikonin me vëmendje fletëlavdërimin, kur Lekja klithi:

— Të keqen nëna, moj Kato! Vitorja e nënës! — dhe puthte letrën gjithë zbulurime.

— Dale, moj, një herë, ta shoh dhe unë!

— Është fletëlavdërimi, — sqaroi postieri. — Vajza po nderon shtëpinë e fshatit.

Lekua ja mori së shoqes fletëlavdërimin nga duart dhe zuri ta shihte gjithë dhemshuri, sikur kishte përpara fytyrën e Katos, pastaj i foli Lekes duke thumbuar:

— Epo ka nga ngjan vajza e babait! I ngjan këtij bir Lekoje, që ç'i she syri i bën dora, — dhe prapë vazhdonte të shihte atë letër gjithë zbulurime, sikur shihte të bijën.

Tërë Dhoksati mësoi që vajza e Lekos që dëlluar mbi shoqet në kurs.

Të gjithë ata që vinin në mulli dhe që e takonin Lekon në rrugë, i flitnin për këtë gjë. Po ai nuk krekosej siç bëjnë disa, megjithatë zemra i bëhej mal, kur dëgjonte t'i flitnin mirë për Katon që e donte mbi të tjerët.

Tek vinte një mbrëmje nga mulliri, aty në të hyrë të fshatit, Lekua dëgjoi që po e thërrisnin. Kur pa nga kopshti i Lipajve, dalloi Viton.

— Ç'ma heq veten aq rëndë, more Leko Millonai? Apo t'u rrit mendja? Kujton se fëmijët e tu zunë qiellin me dorë?

— Moj Vito llafazanja, — u përgjegj Lekua i prekur në sedër, — mendja ime s'është rritur, po është rritur gjuha jote, që duhet shkurtuar pak. Po shiko punën tënde, se nuk je në rregull. Këto të them unë! — dhe u bë Lekua spec i kuq.

Vitua që s'pyeste andej, vazhdoi:

— Hajde, more Leko, hajde! Jepi mend botës tani! S'ke faj, të mësojnë fëmijët nëpër shkollat e qyteteve. Nuk ke dëgjuar San-Lluiz zotrote.

— San-Lluizin ja kam lënë Kiços tënd! E more vesh, apo jo? Ma kanë bërë zabit misterët dhe po merr më qafë kurbetllinjte e tjerë. Andaj më flet dhe ti kështu. Kujton se nuk i dimë ne këto?! — shfryu Lekua me inat.

Vitua u verdh nga këto fjalët e fundit dhe e ktheu fletën shpejt.

— More Leko, nxirri krye fjalës. Ç'janë këto marrëzira që thua? Tim shoq e shtypin amerikantë. Ai ka qenë i kuq qysh në krye të kohës.

— Ato shiti gjetskë! Yt shoq është pis i zi e

jo i kuq. Sa për të shtypur, janë të tjerë ata që shtypen! Është Mitro Vasua me shokë. Apo nuk e di si e kthyen nga rruga Mitron tek nisej për t'u ardhur pranë fëmijëve. Dhe këtë të mirë ja bëri yt shoq, që i futi spica në polici. Ruaji mirë ato fotografitë e Kiços, me rroba zabitësh, që m'i ke vënë në ballë të dhomës! Kënaqu me ato copa kartash, po ne s'ta lemë të na kthehet me kërbac në dorë!

Kështu që shfryrë atë mbrëmje Leko Rrapi. E ndjeu veten të kënaqur, që e mori hakun si duhet. Andaj u ngjit lehtë-lehtë përpjetë sokakut duke mërmëritur:

— M'i kanë dhënë dhe triskë fronti! Ajo ësh-të për t'u lipsur.

Ata që dërgonin letra nga Amerika, flitnin keq për Kiço Lipen, i cili kishte lënë hotelin, që pat në San-Luiz dhe që futur në polici. Kurbet-llinjte po vuanin njëmijë të zeza nga ai.

* * *

Të palarat e Vitos dualën natën që u bë kontraktimi për mbjelljen e duhanit. *) Kur erdhi radha e Margës së Priftajve, plasi gurguleja:

- Eja të firmosësh, Margë! — e ftoi Mihua.
- Nuk vë firmë unë, sikur bota të përmbysset! — foli tërë inat Marga dhe goja i shkumbëzonte.
- Ç'të gjeti, moj derëzezë, ti më ke ato vaj-

*) ... e duhanit = kuptohet se në tregim bëhet fjalë për fshatin e pakolektivizuar, në vitet e para mbas çlirimit. Mbjellja e duhanit ka pasur rëndësi për ekonominë tonë.

za, që jo për dy dylým, po as për dymbëdhjetë nuk pyesin.

— Vajzat mos m'i zërë në gojë zotrote! — ju shkreh Marga Telo Janit. — Vajzat sot janë e nesër s'janë. E di këtë, apo jo?

— Po sot i ke, o Margë! — i foli prapë Telua.

— Po mbase kam ndërmend t'i martoj qysh nesër? Prandaj mbaj vendin, se nuk të ka vënë njeri avokat këtu! — kështu e vuri përpara ajo Telon.

Atje te dera radhët u prishën. Përpara tryezës, ku qendronte komisioni, doli një vajzë bojallëshë, flokëverdhë e faqekuqe. Ishte Zoga, vajza e Margë Priftit. Duke marrë frymë me zor, ajo ju drejtua së jëmës:

— Pse gënjen, mëmë? Si nuk të vjen turp? Thuaj që më ka mbushur mendjen Vitua e Lipajve të mos vë duhan. Keni një javë që këto gjëra bisedoni me të. Këto thuaj!

Vajza u skuq në fytyrë dhe merrte frymë thellë. Pa ju derdh dhe e ëma pastaj, gjë pa thënë nuk i la.

Zogëz i erdhi turp nga njerëzit. Në dritën e kandilit dukej fytyra e saj e trandafiltë, që vende-vende merrte një çehre të verdhë.

Vitos i ra hija e vdekjes.

Fshati e gjeti shkakun e të gjitha këtyre prapësive.

U mësua pas disa ditësh që Vitua u burgos. Bashkë me papa Nestin e Gjatit, ajo kishte kohë që pu-

*) Jorgo Rizua = dëshmor, ra heroikisht më 12 nëndor 1944, në fushën e Peqinit, duke u hedhur mbi tankun armik.

nonte në shërbim të armiqve të jashtëm. Po i hasi sharra në gozhde.

* * *

Lunxhëria kremtonte dhjetëvjetorin e formimit të Batalionit «Misto Mame». Çdo gjë kishte marrë pamjen e festës atë ditë në Nokovë. Sheshi kundru-all shkollës ziente nga njerëzit. Një tok vajza me kostume lunxhe hidhnin vallen e Jorgo Rizos *), që dha jetën duke sulmuar mi tankun fashist.

Ja, më në fund u dëgjua zhurmë automobiliësh, një veturë, dy, tri, më pas një kamion e mbylli vargun e automobilëve. Fëmijët ju vunë pas ZIS-it, duke thirrur të gëzuar. Kamioni u ndal në fund të sheshit. Nga kabina zbriti shoferi dhe një vajzë leshverdhë. Ishin Katua e Pilua, të bijtë e Leko Rrapit, që kishin ardhur dhe ata për të kremtuar këtë ditë të shënuar.

Si zbritën, Pilua i erdhi një herë rrotull automobilit, po Katos nuk ju ndenj. Ajo çau nëpër atë mizëri njerëzish, duke hedhur vështrimin sa andej-kënde, për të parë ndonjë nga të shtëpisë, po s'i zunë sytë njeri. Te rrapit u takua me Zogën e Priftajve. Sa i kishte zënë malli vajzat! U puthën ashtu buzë më buzë, përqafuan njëra-tjetrën, duke qeshur, dhe nuk shqiteshin.

— S'të njoha fare, moj Kato! — i foli Zoga, duke ju dredhur zëri nga mallëngjimi. — Ti paske ndryshuar fare, moj xhane, — dhe prapë e përqafonte.

*) Jorgo Rizua — dëshmor, ra heroikisht më 12 nëndor 1944, në fushën e Peqinit, duke u hedhur mbi tankun armik.



Gratë e Dhoksatit po rregullonin mishrat dhe ëmbëlsirat, kur lajmëruan që erdhi Katua. Lekja mbeti në vend kur dëgjoi këtë lajm prej fëmijëve.

— Ngrehu, moj, se të ka ardhur vajza! — e nxitën shoqet.

Ajo u ngrit në këmbë dhe fytyra i qeshi nga një gëzim i papërshekruar. Sa s'fluturonte. Me gjysmë fryme u nis nëpër grumbullin e njerëzve, duke murmuritur emrin e së bijës, sa që, kush e shihte, çuditej me të. Te rrapi i gjeti fëmijët e saj në mes të dhoksanjotëve. Kur i pa të dy, vajzë e djalë, nuk ju ndjenj pa thirrur:

— Pilo! Kato!..

Të gjithë i hapën vend dhe ajo u drejtua te Katua, e përqafoi duke e shtrënguar në gjoks, e puthi në faqe, në buzë, u mori erë flokëve dhe nuk ngopej me të bijën. Pastaj përqafoi Pilon dhe shoferi, që më kishte atë trup të shëndoshë e të gjatë, u përkul mbi të jëmën, së cilës kishin filluar t'i rridhnin lot malli.

U drejtuan pastaj në mes të sheshit, kur, në grumbullin e njerëzve, dalluan trupin e gjatë të Lekos. Nga gëzimi, sytë i shkëlqenin. Medalja e Trimërisë i tundej, kur vinte duke shpejtuar. U derdh pastaj nga fëmijët... Si i përqafoi, u vuri duart mbi supa dhe filloi të bisedojë me ta shtruar; dukej që malli ja kishte zhdukur inatet e vjetra. Pastaj rrudhi vetullat dhe, me vëmendje, zuri të shikojë të bijën.

— Erdha për fare, baba! Më kanë emëruar infermiere në fshat, — foli Katua që desh t'ja shtonë gëzimin Leko Rrapit.

Millonait ju çel fytyra dhe fjalët zunë t'i rrjedhin çurg:

— Po ti, more, ç'i ke këto? — ju drejtua pastaj të birit Lekua, duke i prekur shenjat që i mbante në gjoks.

— Unë jam nga ata «të njëqindmijëshit»,*) — u përgjegj ai pak si krenar.

— S'marr vesh unë nga këto. Ç'jeni ju «të njëqindmijëshit»? Thuajma shkoqur mua!

— Ne, baba, jemi nga ata që i ruajmë automobilot si sytë e ballit dhe punojmë pa u kur-syer.

— Kështu ju do dhe babai! Punoni me sa fuqi që kini! — tha Lekua, pa ua hequr duart nga supat. Pastaj, duke ju drejtuar Pilos, i foli rëndë-rëndë:

— Dhe ti të ma mbash atë fjalë që më shkrove dikur në letër!

Shoferi zgjati trupin, sikur desh të arrijë babanë dhe, i matur, tundi kokën, duke ja pranuar babait atë fjalë...

... Nga larg dëgjohej kënga:

*Sa bukur demokracia,
këndon bilbili këndon*

*) «Të njëqindmijëshit» = lëvizja «Për njëqindmijëshin» u përhap gjatë viteve '50 në vendin tonë. Ajo që lëvizje e shoferëve pararojë për shfrytëzimin e maqinave pa revizionim kapital për një kohë të gjatë pune.

NGJË NGJARJE NË LUGAXHI

Shërbeja si mësues në fshatin Lugaxhi të Çermenikës. Dimri i atij viti ka qenë i mërzitshëm. Gjatë atyre muajve, përroi i Benës na shurdhoi me zhurmën e tij. Balta e madhe dhe shiu me gjy- ma s'na linin të kalonim prakun e derës. Nga fillimi i dhjetorit zuri të përhapej dhe sëmundja e fruthit. Vinte fëmija dhe merрте një çehre të kuqe në fytyrë, sytë i shndritnin, kolla i zinte frymën, pastaj shtrihej në dyshek dhe ethet e forta e mundonin për ditë të tëra.

Një mbrëmje, sa qeshë rregulluar në dhomën time, isha ulur pranë tryezës dhe po lexoja. Zjarrri brambullonte në oxhak dhe llamba në mur ndriçonte për bukuri. Lexoja dhe s'doja t'ja dija as nga trokitja e pikave të shiut mbi dritare, as dhe nga fishkëllima e erës... Veç kur dëgjoj të më thërrisin. Mbajta vesh. Ishte një zë gruaje, që vinte si me të lutur:

— Shoku mësues, o shoku mësues!

Vesha pallton dhe dola jashtë. Poshtë shkallëve, me një fener në dorë, qëndronte hallë Selimja. Në kokë kishte hedhur një rrobë të leshtë, po prapëseprapë shiu e kishte bërë qull.

— Eja, moj hallë! Futu brenda, — fola i nxi-tuar. — Ç'të pruri në këtë kiamet?

— Mos më pyet! — tha duke hyrë, — Lili... po më vdes Lili. — Plaka mbërtheu pëllëmbët mbi kokë dhe lotët zunë t'i derdheshin çurg.

Zemra filloi të më rrahë me të shpejtë, dhe më pushtoi ajo ndjenjë, që rrok njerëzit kur mësojnë lajme të tilla. «Nxënësi im po vdes». Ky mendim më turbulloi. Po mblodha shpejt veten dhe zura të pyes hallë Selimen:

— Po mirë, moj hallë, na trego një herë si është puna!

— Ka tri ditë që nuk fut gjë në gojë. Sot është ligështuar mjaft. As ha, as pi. Digjet zjarr. Në drekë fliste dhe përçart, po tani as lëviz, as i çel sytë. Qyqja unë, i lava duart nga nipi! Lil, o Lil i nënës!

Djali i madh i hallë Selimes pat rënë dëshmor në prakun e çlirimit. Mbas këtij hidhërimi kishte lindur Lili, që u bë gëzimi i shtëpisë. E reja s'u largua fare nga shtëpia e të shoqit. Shkoi si mos më mirë me të vjehrrën dhe të dyja përpiqeshin ta harronin dhembjen e madhe duke shtuar kujdesin për të voglin. Po ja që Lili atë natë ishte shumë rëndë.

— Mos u tremb, hallë! Kështu e ka fruthi. Nuk ka gjë nipi. Do të shërohet, — i fola plakës duke i dhënë zemër.

Befas diç m'u kujtua. Në valixhe kisha disa kokrra sulfamide. Mbaja mend nga një libër sanitarësh se këto lloj kokrrash janë një bar i mirë kundër fruthit. Kërkova andej e këtej dhe mezi i gjeta. I numërova një nga një. Ishin plotë dhje-

të. Pastaj i shtrëngova në grusht. Me atë pasuri mund të shpëtoja jetën e një fëmije.

— Eja, hallë! Lili do të shëndoshet, — i fola krejt i sigurtë në vetvete. Ajo më ndoqi pas.

Jashtë kishte rënë mjegull e dëndur. Shiu kishte nisur të pushojë. Duke ecur, këmbët na zhyteshin nëpër pellgje me ujë. Nga larg vinte zhurma e përrënjeve dhe e rrëkeve. Një erë zuri të fryjë nga veriu. Dukej se moti do të ndreqej. Arritëm në shtëpinë e hallë Selimes.

Hymë në dhomën e miqve. Një llambë me vajguri ndriste fytyrat e mërzitura të njerëzve. I sëmuri dergjej i shtrirë në këndin e dhomës. E ëma i qëndronte mbi krye. Mbi faqet e saj dukeshin gjurmët lotve. I përshëndeta të gjithë sa ishin dhe ju afrova pranë Lilit. I ndeja të koka dhe zura ta vështroja tek merrte frymë lehtë. Bula djerse i mbulonin fytyrën.

— Lili! O Lili! Shih, të keqen, kush ka ardhur! Shikoje mësuesin, — i fliste e ëma. Po djali as që përmendej.

U mallëngjeva. Afrova pëllëmbën mbi ballin e nxënësit tim. Përvëlonte.

— Lili! — Hapi sytë, o Lili! Shikomë pak, — i fola qetë-qetë. Për çudi, djali i hapi kapakët e syve. Rrotulloi bebet e vogla anej e këndeje, pastaj mbërtheu shikimin e tij mbi sytë e mi. Më kënaqi ai shikim.

— Si je, o Lili! — pyeta me një zë plot shpresë. Ai nxori një rënkim të lehtë dhe, si perëndoi sytë mbështeti prapë kapakët mbi kapakë.

Mora një sulfamide dhe u mundova ta çoj djalin ndenjor. Me zor u ngrit, po kokën e mbajti gjithnjë mënjanë, të varur mbi supin tim.

— Përcille këtë, kjo do të të shëndoshë, — i fola duke i dhënë kokrrën e sulfamides.

— Përcille t'u bëftë nëna, — tha gjyshja.

— He, — murmuritën të gjithë sa ishin.

Djali çeli buzët si me pahir, po kokrrën nuk mundi ta përcjellë dhe e nxori jashtë përsëri. U mundova t'i jap një kokërr tjetër, po s'qe e mundur. Fëmija nuk qëndronte më ndenjtur. Kokën e kishte varur fare dhe dukej mjaft i ligështuar. E shtrimë në shtrat dhe për një çast zumë të shikojmë njëri-tjetrin në sy.

— Ujë!.. — kërkoi Lili me atë zë të fikur.

— Veç ujë ka pirë sot! — u ankua e ëma.

— Sille gotën me ujë! Sillmë shtypsin dhe një pjatë! — i fola së jëmës. Ajo i solli të gjitha dhe unë zura të shtyp një kokërr sulfamide. Si e bëra pluhur, e hodha në gotën e ujit dhe ja dhashë Lilit. Ai afroi buzët e thata te gota dhe rrëkëlëu gllënjkat e ujit për të shuar zjarrin që i ndizej për-brenda.

Të gjithë heshtnin. Era çohet kohë mbas koke dhe përplasej mbi dritare. Zhurma e xhameve që lëkundeshin, prishte qetësinë e dhomës. Unë kisha ngulur vështrimin mbi fytyrën e Lilit. Lëngata e tij ishte e rëndë. Sulfamidet e mia nuk do të bënin punë të madhe. «Si do të vente halli?» Kur ngrita kokën, vura re se të gjithë m'i kishin qepur sytë. Atëhere preva heshtjen:

— Pse nuk lajmëruat infermierën e Orenjës, kur e dinit se djali është kaq i sëmurë!? — Këto fjalë i thashë me zë të butë, po brenda vetes fshihja zemëratë.

— Lajmëruam, o Gjike, vetë isha atje gjithë

pasdreken, — m'u përgjegj kryetari i këshillit, që më rrinte në krah.

— Pse nuk erdhi pastaj?

— Ndodhej në lokalitet. Një doktor ka ardhur atje nga Tirana dhe ka mbledhur infermierët e krahinës për punë të fruthit.

— Porositët njeri që të vinte këtu mbasi të kthehej?

— Po.

— Ai është kurdoherë i papërtuar. Ç'do t'i ketë ndodhur që s'erdhi, — fola unë i çuditur.

Kryetari mblodhi supet.

— S'do ta ketë lënë koha e prapët, — u përgjegj hallë Selimeja në vend të tij.

Kjo bisedë u zhvillua shpejt e shpejt midis nesh, pastaj asnjëri nuk hapi gojë.

Mbas pak më ndriti fytyra. Diçka më shprepi në kokë.

— Si do t'ja bëjmë, shoku kryetar? — dhe, pa pritur përgjigje, i fola prapë:

— Eja të nisemi për në Orenjë!

— Do të shkoj vetëm, — tha ai dhe brofi në këmbë i pari.

Ishte njeri i gjindshëm për çdo nevojtar kryetari i këshillit. Po atë natë nuk e lashë të merrte rrugën vetëm. Ma hante mendja se do ta gjenim atje doktorin dhe mund ta merrnim edhe atë me vete.

— Rri, o Gjikä! — nguli këmbë kryetari.

— Rri, shoku mësues, ku do të shkosh tani natën! — më tha më se një herë hallë Selimja.

Po unë e kisha mbledhur mendjen top.

Kur u nisëm, halla na përcolli deri matanë gardhit; më dha fenerin dhe na uroi rrugë të

mbarë, Ne, si u rrotulluam për të gjetur ndonjë shul, muarëm rrugën e Orenjës.

Shiu kishte pushuar dhe mjergulla qe shpërndarë, po ishte ende errësirë. S'kishte hënë. Qëlluam që të dy këmbëshpejtë dhe e muarëm atë rrugë me të katra. Rrallë e tek ndërronim ndonjë fjalë, dhe këtë e bënim vetëm kur vareshim tatëpjetë. Atëhere ndonjëri prej nesh i thoshte tjetrit:

— He, mbahu! Ki mëndjen aty!

Orenja nga Lugaxhiu mban një orë e gjysmë. Të dy fshatrat ndahen në mes nga «Zalli i Gurakuqit», i cili dimrit, mbas shirave, vjen trap më trap. Kur po i afroheshim këtij dhe zhurma e ujërave të rrëmbyera arrinte e qartë deri te ne, zëmë të qajmë hallin me njëri-tjetrin. Si do ta kalonim gjithë atë përrua? Si do ta gjenim vahun nëpër errësirë, se ky «Zalli i Gurakuqit», kur vjen plot zhurmë duke rrukullisur gurë e drunj, të shtie frikën ditën e jo natën.

Ndërsa bisedonim me njëri-tjetrin, dëgjuam një zë, që vinte nga afër zallit. E ndalëm çapin dhe mbajtëm vesh. Dëgjohej oshëtima e ujërave, pas-taj po ai zë i largët:

— Hej, hej! .

Për një çast gjithë gryka jehonte dhe nëpër atë qetësi nate, ajo thirrje të ngjallte një ndjenjë të çuditshme.

— Mos u përgjegj një herë! — tha kryetari duke më zënë për krahu. Bëmë dhe disa hapa përpara dhe po atë zë filluam ta dëgjonim tani më afër:

— Hej, hej! Kemi humbur rrugën, o shokë! .

M'u duk zë i njohur, prandaj ja ktheva me të riadhe:

Cili je ti, orë?

— Gjokë Lufi, infermieri!.

— Eja këtej, or Gjokë, eja nga drita! — thirri kryetari.

Të dy u ngjitëm në sopin që ndodhej mbi rrugë. Kryetari më rrëmbeu fenerin nga duart dhe engriti mbi vete, në mënyrë që drita të shquhej rreth e qark. Ndenjëm e pritëm atje, duke i ngulur sytë në errësirë dhe duke i bërë veshët pipëz. Herë-herë dëgjonim zërin e Gjokës, që thërriste andej poshtë:

— Ku jeni, o shokë!

— Këtu, këtu! Eja në drejtim të dritës, — i përgjigjeshim ne. Pastaj ja fillonim bisedës.

— E dija unë, mor Gjokë, që s'rrinte pa ardhur ky. I fortë ka qenë.

— More, si e ka kapërcyer përruan në mes të natës? — ja prita unë kryetarit.

Tek bisedonim ashtu me njëri-tjetrin, dëgjuam zërin e Gjokës.

— Hej, hej!

— Eja, mor i bekuar, eja se arrite tani! — folëm që të dy me një zë.

— More, sikur janë dy veta! — foli kryetari.

— Ashtu më duket edhe mua. Ja, një, ja dhe një tjetër. Po ai cili është?

— Mos është doktori?

Hijet u afruan dhe tani i shquanim mirë. Infermieri i gjatë dhe mbrapa, një njëri me trup mesatar. Cili ishte?

— Eja, Gjokë, se për te ti ishim nisur! — i foli infermierit duke e përshëndetur.

— Jam bashkë me doktorin. E pësuam keq sonte, — dhe, si u mbush me frymë, pyeti tërë hall:

— Si është fëmija?

— Keq, — ju përgjegja.

— Ndonjë komplikacion, sigurisht.

Ndërkaq ja, arriti doktori, një djalosh i ri, i veshur me palto të zezë. Mbante në kokë kasketë, e cila ja mbliidhte flokët e shumtë.

Takimi me doktorin qe një nga ato çastet që ndodhin rrallë në jetën e njeriut. Dhe ja pse.

Kur zumë të rrokemi për qafe, vërejtta fytyrën e tij: fytyrë e njohur! «More jam a s'jam në vete unë?».

— Ti je, more Pëllumb? — e pyeta një herë i pasigurtë.

— O, Gjika! — ma priti doktori. — Po ty ç'të pruri këtu?


— Ty ç'të pruri! — ja ktheva unë. Pastaj u rrokëm për qafë edhe një herë. Që nga koha e mbarimit të shkollës së mesme nuk qemë takuar edhe një herë me njëri-tjetrin. Dhe ja tani, në mallet e Çermenikës, e pruri rasti të piqemi mbas shtatë vjetësh. Kishim ndryshuar, kjo s'do mend, po gjallëria e viteve të shkollës vlonte gjithnjë në zemrat tona.

Si u shkëputëm nga krahët e njëri-tjetrit, zumë të shiheshim prapë në sy. Doktori ma hodhi dorën në sup dhe s'i mbahej gazi. Pastaj fytyra e tij mori menjëherë një pamje të vrenjtur:

— Si është fëmija?

— Shumë keq! — ju përgjegjëm ne.

— O burra të nisemi! Ç'presim?! — foli doktori shpejt e shpejt. Të katër, varg njëri pas tjetrit, ju ngjitëm së përpjetës për në Lugaxhi. Dukej sikur asnjëri nuk e ndjente lodhjen e të ftohtin. Gji-



thësekush mundahej të shpejtonte më tepër nga të tjerët.

Për të gjitha ato, që kishin pësuar rrugës, as infermieri, as doktori nuk hapën gojën. Makar të na tregonin ç'kishin, hequr gjatë kalimit të zallit. Jo, jo! Vetëm të nesërmen mësuam se si ata ishin nisur në mes të shiut nga Orenja. Natën kishin arritur në përrua. Kur kishin hyrë për ta kaluar, kishte zënë e ishte mbushur zalli plot e përplot, sa nuk dalloje më vahun nga pellgu. Nata po kishte qenë pus. Një rrymë uji, duke ardhur me vrull e duke sjellë me vete gjithçka, kishte rrëzuar infermierin. Nuk e di pastaj si ndodhi që ata të dy kishin dalë në breg. Po rrjedha e ujit i kishte nxjerrë larg rrugës. Ishin endur andej e këtej nëpër errësirë, kishin hyrë në një arë e dil në një arë tjetër, duke u zhytur në ato balta argjilore, po rrugën s'e kishin gjetur, që s'e kishin gjetur. Pastaj kishin dëgjuar atë thirrje.

Duke u ngjitur përpjetë rrugës, doktori shpejtonte i thelluar në mendime. Vetëm kur ne të tjerët fillonim bisedën dhe ngadalësonim hapin, ai zinte e na fliste:

— Hë, o burra, të sosim sa më parë!

Atëhere muhabeti ndërpritej për një copë herë dhe zhurma e pantallonave të lagura dëgjohej e qartë:

— Fësh - fësh, fësh - fësh!

Kur ju afruam fshatit, një erë e fortë u çua përsëri nga veriu, duke sjellë me vete të ftohtin e maleve. Mbas pak, nga ferra pranë rrugës, një lepur u largua i trembur.

Erdhëm, më në fund! — fola unë.

Ndërkaq u duk përtej drita e llambës në shtë-

pinë e hallë Selimes. Qentë zunë të lehin me të madhe.

Plaka na priti në krye të shkallëve. Ajo u përshëndet me infermierin dhe doktorin, po, kur ja dha dorën këtij të fundit, shtangu.

— Jam doktori, moj hallë! — tha ai. Atëhere plaka e përqafoi.

— Qofsh i gëzuar, o bir! Si ta thonë emrin?

— Pëllumb!

— Pëllumb qenke me të vërtetë, o djalë! Eja të thahesh, se qenke bërë qull!

— Kemi kohë, moj hallë, — foli doktori duke na prirë vetë në dhomë. Në oxhak sa ishte hedhur një krah dru. Zjarri kishte zënë e flakëronte. Të renë e gjetëm pranë Lilit. Ajo na priste në këmbë, e pezmatuar, me duar të mbërthyera mbi brez. Si me drojtje i zgjati dorën Pëllumbit dhe, kur ai zuri të shohë djalin, asaj një nga një ju shkëputën lotët mbi faqe. Doktori ngriti sytë dhe vështroi, atëhere ajo e ngashëryer i tha:

— Aman, doktor, më shpëto Lilin! E kam të vetëm.

— Hesht, moj shoqe! S'ka gjë djali! — ju përgjegj ai. Pastaj rroku dorën e fëmijës dhe zuri të masë pulsën duke picërruar sytë.

Hallë Selimeja e mbante veten, ajo vështroi pa bërë zë. Po, kur pa që së resë s'i mbaheshin lotët, i foli plot inat:

— Ma lërë mua djalin, s'është kohë për të qarë tani! Ngrehu dhe rregullo miqtë, se janë të lodhur!

E reja ja dëgjoi fjalën.

Si vërejti pulsën e të sëmurit, doktori nxori fenendoskopin dhe zuri të vërejë fëmijën gjithkrah.

Plaka dhe infermieri e ndihmonin. Unë me kryetarin vështronim në këmbë, kurse e reja, duke i mbajtur sytë nga fëmija, nuk shihte kafën, që derdhej nga xhezveja. Lili, as lëvizte, as bënte zë. Sytë i mbante gjysmë të mbyllur. Sipër buzëve i ndritnin pika djerse. Vetëm nga ajo frymëmarrja e lehtë dallohej që ai djalë jetonte.

Si e vërejti të sëmurin mirë e mirë, doktori hoqi veglën nga veshi dhe zuri të mendohej.

— Ti, Gjokë, rregullo shiringat! — i foli infermierit. Pastaj murmuriti me vete fjalën «komplikacionin».

— Ç'ka djali, shoku doktor? — e pyeti atëhere plaka.

— Fruth i rëndë, moj hallë, ka marrë për ters sëmundja! — tha Pëllumbi.

— Po a ka shpresë shpëtimi? — vazhdoi ta pyesë ajo.

— Si jo, për këtë punë jemi ne doktorët, — dhe, duke ju drejtuar infermierit, i foli me nxit:

— Shpejt, Gjokë, pregatit penicilinën!

Infermieri i shkathët u gjend menjëherë pranë fëmijës. Mori dorën e tij, e cila u ngrit sikur të ishte pa jetë, dhe zuri t'i ngulte majën e gjilpërës. Ne të tjerët vërenim të mbështetur njëri mbas tjetrit.

— Dhe një kafeinë! — murmuriti doktori pastaj.

Infermieri veproi ashtu si i thanë. Si bëri inxheksionin e dytë, fshiu djersën që i mbulonte ballin.

Pëllumbi nuk bëri zë. Ai qëndroi kërrusur mbi djalin, duke vërejtur herë pulsën, herë frymëmarrjen. I vinte Lilit dorën në ballë dhe mendohej.

Për bukë nuk na shkoi ndërmend fare. Gjithë natën asnjëri nuk u preh. Doktorin dhe infermieri ndenjtën mbi krye të të sëmurit. E reja qëndronte bulë helmi pranë tyre. Halla e mbajti veten. Ajo u vinte rrotull miqve dhe shuante e ndizte cigaret njërin pas tjetrit. Unë me kryetarin u shtrimë aty, rrëzë vatrës, për të marrë një sy gjumë. Po nuk qe e mundur. Sa zija të kotesha, dëgjoja zërin e doktorit:

— Hë, Gjokë, edhe një penicilinë!

Atëhere kthehesha në anën tjetër dhe me sytë gjysmë të mbyllur shihja doktorin e kërrusur mbi fëmijën, me ato flokë të shprishur, që i kishin rënë nga çdo anë.

Kur Gjoka mbaronte punën e tij, Pëllumbi rrëmbente dorën e Lilit dhe për minuta të tëra vërente pulsën. Në dhomë kishte qetësi.

...Vonë shumë më ishin mbyllur sytë. Aty nga mëngjezi ndjej që më zënë përkrahu. Më shkoi mendja tek e keqja, kur vështrova, pashë doktorin që ishte përkulur mbi mua dhe fliste i papërmbajtur:

— Ngrehu, Gjokë, se nxënësi yt po shërohet!

U ngrita fluturimthi dhe ju afrova të sëmurit.

— A e ndjen si ka filluar të marrë fyrmë në rregull? Shih pulsën! Ja dhe temperatura ka filluar t'i bjerë! — Këto fjalë doktorin i thoshte gjithë gaz. Atëhere plakës nuk ju ndenj pa thënë:

— Nuk kam si të ta shpërblej këtë të mirë, o Pëllumb!

— Nënë! — i foli doktorin duke i rënë krahëve.

— Shpërblimin ma ke dhënë me kohë.

Plaka zuri të shikojë e habitur, duke i ngulur

sytë herë-herë nga e reja; po edhe ajo shtangu.
«Ç'ishte ky shpërblim?»

— Çfarë shpërblimi të kam dhënë, o bir? —
pyeti halla pa shejtanllëk. Doktorin qeshi. Qesha
dhe unë, që e kuptova ku rrihte ai.

— Shpërblimin ma ke dhënë ti, djali yt dësh-
mor, ai tjetri e tjetri; ma dha populli, kur më
dërguan në shkollë për t'u bërë doktor. Tani unë
kam ardhur këtej për të larë atë nder, që më ësh-
të bërë. E kuptove, hallë, apo jo?

Atëhere plaka e puthi doktorin në ballë.

Fëmija hapi sytë. Ata sy tregonin gjallëri.

— Mëmë! — thirri Lili.

— Shpirt i mëmës! — ju përgjegj e ëma dhe
u kërrus ta puthte.

— Mos! Është e ndaluar! Pa! Pa! Pa! — i fo-
li infermieri me zë të rreptë. Atëhere ajo u shtang
dhe zuri të vështronte e habitur infermierin.

Kryetari që rrinte mbi shtrat me jorgan mbas
krahëve, filloi të qeshte me të madhe.

— Jo, nuse! Ku është doktori, ka rregull! S'e
ditke që i sëmuri nuk duhet puthur?

E reja u bë flakë e kuqe.

Drita filloi të bjerë dhe dielli nëpër xhamin
e baxhës futi rrezet e ngrohta në dhomë. Zogjtë ja
filluan cicërimës në gardhin kundruall dritares. Nga
e përpjeta e kodrës vinte tringëllima e zileve të
kopesë.

ËNDËRRA

Kur fshatit dëgjohej gurgullima e përroit dhe lehja e qenve, hëna ngrihej mbi Stravua. Te hau-ri i Meto Goxhajt niste atëhere një këngë, këngë labçe nga ato të çobenjve... Mazja ja merrte dhe Mineja ja kthente e pastaj ëmë e bir e zgjatnin me një iso që dëgjohej në krua e përmatanë zallit.

Një djalë kishte Mineja dhe kokën linte për të. Si nënat me fëmijë të vetëm edhe ajo i shkonte pas djalit... Po Mazja kishte teka për të qeshur.

— Mëmë, bëmë vezë të skuqura sot. Mora pesë,* — dhe Mineja tiganin në zjarr.

Nganjëherë djali nuk thërriste që nga lesa e gardhit; ai vinte qetë-qetë nga shkolla dhe me zë të ulët pëshpëriste:

— Mëmë, sot nuk mora pesë, katër mora.

Atëhere Mineja e shikonte si me qortim dhe, duke fshehur një farë gëzimi, i thoshte:

— Nesër mos harro të na marrësh pesë!

Mbrëmjeve Mazja rrinte gjer vonë pranë zjarrit. Mineja tirrte; tirrte dhe bishtuku aty mbi vatrë një vijë të drejtë tymi që linte vula mbi trarët

*) Flitet për sistemin e mëparshëm të notave.

e ahurit. Kur kolopuçi mbaronte mësimet, mëma linte punën dhe niste kënga, këngë tërë gaz, siç mund të këndojë nëna me djalin e vetëm. E pastaj fillonte një bisedë e këndshme. Mazja thurte ëndrra. Zor të ëndërrosh në moshën nëndëvjeçare, po ja që Mazja ëndërronte. Jo për t'u bërë pilot, as për të rrokur hënën; mësuës donte të bëhej Mazja.

— Mëmë!

— Shpirti i mëmës!

— Kur të rritem, do të bëhem mësuës.

— Mësuës bëhu, të keqen!

— Do të vete nëpër shkolla të mëdha, moj mëmë!

— Pa dale një herë. Mua ku do të më lesh?

— Po jo, moj mëmë, jo. Do të mbaroj shkollën në fshat një herë, pastaj do të shkoj në unike, pastaj në qytet; kur të mbaroj atë shkollën e qytetit, do të vi në fshat përsëri.

Mineja qeshte nën buzë e zemra gaz i mbushej. Mazes i picërroheshin sytë.

— Atëhere fli, t'u bëftë mëma!

Dhe binin. Mineja përqaftonte qëngjin e saj dhe nuk mbyllte sy. Ajo ndjente frymëmarrjen e të birit dhe i bëhej sikur dëgjonte një melodi të ëmbël, si shushurimë krojesh, si fërfëllimë fletësh. Tërë natën shtrëngonte në gjoks birin dhe ëndrrat e tij, që i kishin përgjysmë.

... Që atë mot Mazja filloi të bëhej mësuës.

Asikohe në Frashnjet u hap shkolla e pleqve. Të moshuarit atij viti u futën në kurset e L.K.A. * Hyri dhe Mineja. Atëhere e mori ajo emrin «doktoreshë». Bëri çantë e bleu gjyslyke dhe në atë shkollë pesëdhjetëvjeçarësh u shqua mbi të tjerët.

*) L.K.A. = Lufta kundër analfabetizmit.

Në fillim lapsin e shtrëngonte me të pesë gishtrinjtë, pastaj e pati më të lehtë. Së pari shkroi «mali», pastaj «Mine», «Metë», «Maze». Mësonte në mbrëmje, mësonte dhe natën. Mbrëmjeve me mësuesin, natën me djalin. E nisi me kërrabëza, po shpejt filloi ta ndreqë shkrimin dhe i qëndiste fletoret me lloj-lloj shkronjash. Ja që u mësoka dhe në pleqëri!

Në mëngjez e niste nëna djalin në shkollë, pasdite djali niste mëmën dhe e porosiste te dera e klasës:

— Mëmë, të na marrësh pesa!

Mësuesi qeshte me gjithë zemër.

Në mbrëmje Mazja priste te lesa. Ja merrte çantën mëmës dhe ja shikonte një për një fletoret.

— Po pse s'paske marrë pesë, moj mëmë? Ooo, dhe ti!

Minen e zinte gazi. Kënaqësia i ngrohte shpirtin, i dilte ndër buzë.

Dhe në darkë, si mbaronte mësimet e veta, Mazja bëhej mësues i mëmës.


— Ja kjo është «n», kjo «m». Kjo ka një urë, kjo ka dy ura. Shkruaj tani.

Shkruante Mineja një radhë, dy... Mazja i rrinte mbi krye dhe, si mësues, rëndë-rëndë herë qortonte, herë lavdëronte.

Pastaj ja merrnin labçe. E ç'm'i zgjidhnin ato këngë! Sa u shkonin ato këngë! Mbas këngëve thurinin ëndërra. Mazja do të shkonte në shkollën e madhe të qytetit, e si ta mbaronte, do të kthehej në fshat mësues.

— T'u bëftë mëma, ore Maze! Mësuesi i vogël i mëmës.

Natën vonë, kur binin për të fjetur, Mazja, duke u kotur pëshpëriste:



— Mëmë, nesër të na marrësh pesë.

...Mete Goxhaj punonte atëhere maleve të Kolonjës e fushave të Delvinës. Tërë jetën u mundua Metja i varfër, po katërmbëdhjetë kokë dhën s'i bëri dot. Trembëdhjetë e nën trembëdhjetë. Mbas çlirimit, kur u formuan ndërmarrjet blegtorale, i dha rrugë ai dhe hyri çoban në një brigadë dhensh. Me tufat e shtetit kulloste dhe të tijën e, duke ve-ruar, bagëtinë, çoku ja merrte me gojë e me zemër asaj kënge të Maze Merkos. Ja merrte asaj kënge, se ëndërra për pasuri nuk i shqitej nga mendja.

Dhent' e Mazes dy-tre mijë,
mbushur një gropë e një brijë.

«Trim i fortë e çelnik *) i zoti ka qenë Mazja i Merkajve,» — psherëtinte thellë e, si në të ri, nxirrte longarin. Fundin e këngës e merrte me të qarë:

*Të shkretat seç blegërijnë,
gjakn' e Mazes ç'e lëpijnë!*

E, pa futur longarin në torbë, i përqafonte ato ftujake e manare sikur t'i kish fëmijë.

— Ja, ashtu dua të vdes dhe unë, moj korba, si Maze Merkua, mes bagëtisë, me blegërima të më ligjërojnë.

Me të tilla ëndërra gudulisej këtu e pesëmbëdhjetë vjet më parë Mete Goxhaj atyre brinjëve të Kolonjës.

I varfëri çoban s'arrinte ta kuptonte se dhentë që kullosnin ditë e net, ishin të tijat e të Mazes së

*) Çelnik = pronar dhensh.

tij. Edhe pse e donte atë bagëti përreth, e donte siç duan mëmat e përvëluara fëmijët e botës.

— Ku ka me tufën tënde, si do që të jetë, ësh-të tëndja. E, or kolopuç i babait, ti do t'i bëhesh Metes çelnik si Mazja që thotë kënga. S'ta kanë vënë kot atë emër!

... Lejen vjetore Mete Çobani s'e mori vjesh-tës, kur tufat e dhenve qenë kthyer në kullotat ve-rore të Delvinës. As dimrit s'qe dukur në Frashnjët. Në fund të prillit çoi lajm se vinte filan ditë e fi-lan kohë. Ka qenë zakon i motit, kur çobanëria kthe-hey nga dimri, fëmijët dhe graria dilnin dhe pris-nin larg fshatit. Sa qe i ri Metja, as dimëroi dhe as veroi, as e përcuallën, as e pritën. Me trembë-dhjetë kokë dhen mblidhej në të nxehtë e në të ftohtë. Verës në ato copë musha *) që i caktonte ple-qësia, dimrit rreth ahurit të tij. Atë vit e bëri fora Metja me atë zakon çelnikësh e zemra ja desh që zakoni t'i mbetej shtëpisë mot pas moti e brez pas brezi.

Tahmazi dhe Mineja e pritën të zotin e shtëpi-së në Skërficë. Veç të shihje atë mbrëmje, kur bëri ballë tufa në Gur të Mokrrave. Plla e shelege zbar-dhonin një copë vend. Tringëllinin këmborë e zile dhe dashi me bipe shkante në krye të çobanit me kësulë e kërrabë.

Mineja shtroi qilime me thekë atë natë. Metja mori shelegun më të mirë dhe e shkoi në hell. Er-dhën pastaj miq e fqinjësi dhe u ndreq gostia aty për aty me raki të vjetër, me djathë nape e mish të pjekur.

Mësuesi në krye e më plaku përkundruall. Më

*) Musha = kullotat e përbashkëta të fshatit.

t'u ngreh një muhabet që s'e kish parë konaku ndonjëherë. E kur të dëgjoje, një labçe, dy dhe isoja gjëmoi.

Ja mbante dhe arësimtari, një normalist nga ata të Elbasanit, dhe habitej Metja me ison e gegës.

Gotë mbas gote, kënga nxori këngën dhe tingujt vajtën dhe qëlluan drejt e mu në zemër të Metes.

Pastroi mirë gurmazin dhe e nisi «Maze Merkon» si pleqtë motit. Sytë i mbylli, kokën e mbështeti në pëllëmbë dhe krahun mbi gjunjë. Këndonte a s'këndonte. Kryetari ja kthente me grykë, të tjerët ja mbanin e Metes ju bë dhen dynjaja. Ai pas dhe Mazja pas tufës.

— Iso, ore, iso!..

Dhe isoja si motit; Metja e merrte me të pre-ra, duke mëshuar në fund gjithë afsh, sikur nxirrite pjesë të zemrës nëpër këngë.

*Mbushur një gropë e një brinjë,
të shkretat seç blegërijnë!*

E pastaj mbytej në këngë çobani. «Isoja» i bëhej blegërimë. Tufa ngjitej përpjetë «Shurit», shpërndahej lëndinave...

*Të shkretat seç blegërijnë,
gjakn' e Mazes ç'e lëpijnë.*

Në të sosur u drodh Metja, me zor e mbaroi këngën dhe u përmend i trembur. Djali i rrinte pranë, mbështetur te gjuri i tij dhe ja kish ngulur sytë në fytyrën e trishtuar. Ai zuri të lëmojë flokët e Mazes. Malli e kish djegur.

Pastaj nisën bisedën. Dukej se Metja mezi kishte pritur që djali t'i bëhej nëndë vjeç e të këshillohej me të.

— Po ti, o Mazja i vogël, a do t'i bëhesh çelnik babait?

— Jo, baba, unë do të bëhem mësues me pedagogjike.

— Ç'janë këto «pedagogjike», more! Çelnik të bëhesh! — foli Metja me të lartë.

Të ftuarit i tërhoqi ky bashkëbisedim.

— Mësues do të bëhem, baba, mësues me shkollë të madhe. Kështu thotë dhe mësuesi.

— Po ku do të gjesh poture e setër të leshtë pastaj? Ku do të gjesh pastaj djathë e gjalpë, kos e dhallë, këmborë e zile? Ku do t'i gjesh, more jezit? — foli Metja si me shaka, si me të nxehur.

Atëhere hyri arësimitari në bisedë.

— Edhe mësuesit s'kanë mbetur zbathur e zveshur, o shoku Mete! Sa për çelnik, çelnikëve u shkoi koha; tjetër puna e çobanit pastaj. Po ç'bëri çobani, ç'bëri mësuesi, një punë është. Njëri rrit e ruan bagëtinë, tjetri rrit e mëson fëmijët. Mësues le të bëhet djali, me që ja dashka zemra.

— E, or gegë, gruan ma bëre të librit e të kalemmit, edhe Mazon tani do ta bësh si veten. Po unë, Mete Goxhaj, s'paskam të drejtë ta bëj djalin çelnik?

— Jo, jo, baba, unë mësues do të bëhem, — foli i vogli duke ngulur këmbë në të vetën.

— Çelnikëve u iku koha, o shoku Mete, — foli Hyso kryetari. — Ata qenë dikur, kur pasuria u hante kokën njerëzve dhe u lëpinte gjakun bagëtia, siç e thotë edhe kënga.

Këto ju ngulën në zemër Metes, të dridhura ja

përshekruan trupin, foli dhe të tjera kryetari, po çobani s'dëgjonte më.

— A s'kam të drejtë? — pyeti Hyso kryetari.

— Të drejtë ke.

— Le të bëhet mësues djali, se na duhen edhe arësimitarë nga fshati.

— Kështu, ëëë, — murmuriti babai i mundur, — le të bëhet, pra! Çoban fëmijësh le të bëhet. Ja, unë hoqa dorë nga imja, po me ndihmën e partisë dhe të qeverisë ama.

— More, mukaheti yt të jetë, pa s'kursehen partia dhe qeveria.

— E bërë qoftë!

Plasi gazi atëhere. Të gjithë qeshën. Qeshi dhe babai me gjithë zemër.

Kështu rrodhi biseda atë natë në shtëpinë e Mete Goxhajt. Kryetari Hyso, njeri me dy barrë mend, që në kandar i peshonte fjalët, ngriti gotën e foli:

— Mosha jonë e dora jonë në errësirë u tërhoq këmbadorazi, honeve na shkoi rinia. Të thur nim ëndërra, as ndërmend s'e patëm në fëmijëri. Hyzmeqar ose kaçak, mos njërën, tjetrën e kishim të siguruar. Edhe ti, o shoku Mete, që gjithë jetën të bëheshe çelnik pate ëndërruar, u bërë nishan me ato trembëdhjetë berrat e tua. Mazja ëndërron të bëhet mësues. Do të bëhet! Sot kemi parti e qeveri, diell e dritë që ndriçon rrugën e fëmijëve tanë. Çuni sa të rritet mund të ketë dhe dëshira të tjera. Po cilado qoftë ëndërra e tij, ajo do të plotësohet se s'bën. Si thoni, shokë?

— Të drejtë ke, o Hyso.

— E po ta ngremë këtë dolli për Maze mësuesin, pra, për partinë e qeverinë, që i bëjnë të rinjtë të thurin ëndërra të bukura!

Nata shkonte e vallja krisi, e gjëmoi shtëpia e dhentë u përziën në vathë. Kërcente Metja dhe Hysua, mësuesi dhe miqtë, gjithë bashkë. Valle burrërishte e grarishte, sipas atij që hiqte në ballë. Kur erdhi radha e arësimitarit, atëhere ai ju lut ta falnin se ende s'ua kish marrë anën valleve të Labërisë. Doli kryetari pastaj në krye. Për t'ja mbajtur, ja mbajti vetë mësuesi dhe Mete Çobani aty për aty ngriti këngën, si veç labi di të ngrerë:

*Deli, moj thëllëza, deli,
po hedh valle Hyso Çeli,
Hyso Çeli kryetari,
Se ç'ja mbante arsimitari,
arsimitari, geg' me halle,
na mësoi të hedhë valle,
të hedh valle labërie,
obobo, ç'mi paska hie!*

Kërceu mësuesi dhe mendja i mbeti te kënga e Metes. Shastisi mbas vargjeve të atij vjershëtari, që pranë e kishte e s'e shihte, me të bisedonte e s'e njihte. Eh, sa njerëz me talent si Metja kishin humbur nga regjimet antipopullore!

«Sa ëndërra s'u plotësuan, sa ëndërra s'u ëndërruan!» — pëshpëriti arësimitari. E, duke fshirë djersën, ju drejtua të zotit të konakut:

— Të lumtë goja, o Mete Goxhaj!

— Dhe ty të lumshin këmbët, o gegë! Gjynah që s'të pata njohur deri më sot! Më ke gëzuar sa s'bëhet.

— Në dasmën e Mazes do ta tundim.

— Në dasmën dhe në plotësimin e ëndërrës së Mazes, — shtoi kryetari.

Vonë mbaroi ajo gosti. Duke u ndarë, mësuesi, si u përshëndet me të shtëpisë, e mori në grykë Mazen e kolopuçi ja mbërtheu duart në qafë e s'i shqitej.

«Mësuesi i madh dhe mësuesi i vogël», murruritën të tjerët.

Gjithsekush u largua, duke ndjerë përbrenda një afsh që të ngrohte shpirtin.

...Sa vite kaluan që atëhere! Sa male e fusha brodhi mësuesi! Sa qafa e përrenj kaptoi! Ngado e ngjeshi baltën e mëmëdheut, po kudo që vajti, dije përhapit e dëshirë për mësim ngjalli.

Ja, në atë shkollë, buzë hekurudhës, jep mësim ai. Në atë portë trokiti para ca ditësh postieri.

Ishte nëndor, mëngjez. Mësimi sa kish filluar. Dikush trokiti në portë. Me vonesë e hapi mësuesi derën.

— Një letër, shoku arësimitar.

Një zarf me adresë të ndrequr disa herë. Nga s'kishte bredhur letra! Po zemrat e kishin gjetur zemrën.

Mësuesi shtangu.

«Dërgon.

Maze Goxhaj
Shkolla Shtatëvjeçare
Frashnjë»

Lexoi përsëri adresën. S'kishte gabuar. E hapi me ngut atë zarf. Një ftesë dhe një letër. Hodhi sytë mbi kartëvizitën: një shkrim prej dore të pamësuar.

«I dashur mësonjës:

Të mërkurë, me 8 nëndor 1961, martojmë djalin tonë Mazen me arësimtaren Kuçupe Nora.

Mos rini pa ardhur. Do të na ndriçoni shtëpinë. Ne s'ju heqim nga goja, ju presim krahëhapur.

Mehmeti — Emineja».

Ai buzëqeshi për një çast dhe pyeti i hutuar:

— Sa kemi sot?

— 10 nëndor.

— Dy ditë më ngadalë të kishte ecur koha!

U vrejti arësimtari. S'e deshi atë përgjigje.

U hutua pak dhe më pas urdhëroi:

— Zgjidhni këto detyra.

Me ngut shkroi detyrën. Nxënësit s'u ndien.

Ata në heshtje kopjuan, në heshtje filluan punën.

Mësuesi u ul në tryezë. Si mblodhi veten, zuri të lexojë letrën e arësimtar Maze Goxhajt. Malli e kish marrë për kolopuçin. Na paskësh mbaruar Institutin pedagogjik.

— Kështu duhej të ndodhte.

Lexoi dhe më poshtë. Fytyra i çelej. Buzëqeshte dhe murmuriste.

Mazja dhe Kuçupja ishin nxënësit e tij më të mirë. Koka i ishte mbushur gjithë përfytyrime, mundahej ta përfytyronte atë dasmë në Frashnjë, po shpesh i dilte parasysh mbrëmja e gëzuar në shtëpinë e Mete Goxhajt. Pastaj çdo gjë në rregull. Ja një dasmë Labërie, nga ato që shpesh kishte jetuar, gjithë gaz e këngë, mushka me belce të kuqe. Po, kur donte të sillte parasysh çiftin e ri, ngatërrohej përsëri. Mazja dhe Kuçupja i dilnin gjithnjë të dy të vegjël, nxënës në klasë të tretë, në bankë të tretë.

VAJZA NGA KLOSI I SULOVËS

Ne shkonim nëpër rrugën e re që e përshkon mes për mes Sulovën. Jemi bashkë me instruktoren e krahinës. Shkojmë larg, në Mollas. Atje do të gjykohet një matrapaz krushqish.

Te ajo arra e madhe, në anë të rrugës, ndalemi të presim gjyqtarët. Instruktori ka vite që punon këndeje dhe vendin e njeh me pëllëmbë. Unë vij për herë të parë. Kjo luginë më mahnit; bregore andej e përkëndeje. Tek-tuk, kodrave, ka mbetur ari i hamulloreve në mes të një deti të blertë e të mëndafshhtë. Misri ka zënë kalli dhe fruti muftatet dhe hazdiset.

— Atje i thonë Qafe, — shpjegon shoku im, duke më treguar një kala ilire majë shkëmbit, — poshtë shtrihet Klosi. Këtu pati një si gjyq tjetër para ca ditësh, po gjykoi fshati, s'patëm njerëz të ligjeve në tribunë.

Kështu filloi instruktori tregimin e një ngjarjeje që kishte ndodhur kohët e fundit.

— Vule Qosja, është ajo rritësja e viçave për të cilën duhet të kesh dëgjuar. Punon në stallë. Kudo na është bërë krah i djathtë; është fort e gjallë. Kur formuam brigadën vullnetare të Su-

lovës, ajo qe e para që çfaqti dëshirën për të punuar në hekurudhë. Shoqet e zgjodhën dhe komandante kompanie.

Është e para herë që dërgojmë vullnetarë prej këndeje. Të gjitha vajzat janë mjaft të gëzuara. Dalja për në hekurudhë ka forcuar te ato besimin në vetvete. Sulovaret s'janë më të parat. Fjala e shokut Enver më 6 shkurt u ka dhënë fletë.

Kjo jetë plot vrull ecën përpara duke u ndeshur me sa e sa pengesa. Ai që gjykohet atje në Mollas ka shokë andej-këndeje. Dhe ata ngrehin lloj-lloj kurthesh. Mendimi i mykur shpik vetëm pengesa të rafinuara. Me të dëgjuar formimin e Brigadës «Qemal Stafa» të Sulovës, dalldisën prapanikët. Në Floq, dikush ngrehu shpejt e shpejt dasmë dhe martoi vajzën që kishte çfaqur dëshirën për të punuar në aksionin e rinisë. Kësi planesh ngritën edhe prindërit e Vules, po s'u eci.

Një mbrëmje, ajo u kthye vonë në shtëpi. Gjithë ditën punoi në stallë dhe në darkë shkoi vargje duhani te hangarët. Aty dhe bisedonte me shoqet. Bashkë thurën plane dhe ëndërra, prandaj dhe orët kaluan pa u ndjerë. Si pa kuptuar u shkuan ata kuinalë fletësh. Qindra vargje duhani ishin gati.

Qe bërë fare natë kur u nda nga shoqet te porta. Mendoj se prindërit do t'i gjente në gjumë, po në shtëpi kishte lëvizje. Në kuzhinë, veç nënës, gjeti dhe «dadanë», atë gruan që merret me rregullim nusesh në fshat. Në dhomën e miqve pa dritë e dëgjoi zëra. Asaj nuk i shkoi mendja për keq. Se mos vetëm kësaj nate gjeti miq në shtëpi?! E ëma s'i hapi bisedë, as «dadaja». Ajo hangri me

uri dhe ra të flerë. Pa gdhirë e prisnin viçat dhe sa e sa punë të tjera.

Ajo flinte, kur në shtëpi erdhën prapë burra e prapë gra të tjera. Ata hynin vjedhurazi nga porta, lëviznin të drojtur dhe bisedonin kokë më kokë me zë të ulët; dilyn prapë e vazhdonin me këto lëvizje të heshtura gjer afër mesit të natës.

Vulja u zgjua atëhere, kur ndjeu se po i merrej fryma. Vapa të mbyste në dhomë dhe, sa hapi sytë, pa mbi krye tri kukumjaçka: «dadaja» me shoqe. Në këto raste njeriu me zor e mbledh veten. Po kur dailoi se gratë po i bënin «shartet e mazinesë»*), e kuptoi shpejt se ç'ishin duke punuar me të. Po e martonin pa e pyetur, pa ditur as ajo se ku po shkonte. Po e martonin shpejt dhe fshehurazi që të mos shkonte në hekurudhë. Sa turp i erdhi në ato çaste! Sa të përbuzur e ndjeu veten! Sa keq i erdhi për prindërit e saj të paçituar!

Po të kishte qenë tjetër kohë, ajo do t'i ishte bindur fatit kokulur. Ajo do të ishte përcjellë e mbytur nën duvak në një drejtim të paditur, te një burrë i panjohur. Po Vulja jeton në kohën e partisë. Fjalën e shokut Enver ajo e mban në gjë. Shoqet e Lekbibajt, dy ditë më parë, i kanë dhënë një shembull të madh.

Vulja e urtë dhe e turpshme u bë e guximshme. U çua nga shtrati dhe ju shkreh kukumjaçkës së madhe:

*) Shartet e mazinesë = zbukurimet që u bëhen nuseve në fshatra.

— Hiqmu sysh, dada! Si s'të vjen turp!

Donte të thërriste, të kërkonte ndihmë, po koha s'priste. Nga dhoma e miqve dëgjoji zëra burrash. Krushqit e panjohur e prisnin.

Atëhere mori nga sytë këmbët. Ku të drejtohej nëpër atë errësirë? Ç'të bënte tërë atë natë? Mori rrugën për në stallë, te viçat e saj. Rojtari plak, që rrinte te porta, dhe shoqet që bënin turnin e natës, u habitën. Ç'donte Vulja në atë orë? Pa e pyetur njeri, ajo ja shkrepri vajit. Donte të zbraste mullanin që i ishte mbledhur përbrenda. Pastaj ua tregoi shoqeve dhe rojtarit fije për pe hallin e saj. Plaku e qetësoi.

— S'ka burrë që afrohet në stallë sa jam unë roje. Ti rri me shoqet e mos u bëj merak. Këto punë do të rregullohen, sa të gdhihet.

Vajzave u ndriti fytyra. Vulja zuri të qeshë me sy gjithë lot të valë.

Nuk vonoi dhe te porta e stallës u dhanë krushqit me babanë e vajzës. Rojtari u doli përpara. Më trimi prej tyre, me zë të shtirur miqësor, i foli gjithë lajka plakut:

— O xhaxha! Jemi ne, ore, jemi ne! Kërkojmë Vulen. Se ku na shkoi Vulja!

— More, kthehi prapë, se s'keni punë këtu, s'keni punë me Vulen.

Krushqit u kthyen nga kishin ardhur. Atëhere vajzat në stallë qeshën me të madhe, të çliruarra, të gëzuara.

Të nesërmen fshati mësoi ngjarjen e Vules. Të gjithë u revoltuan për atë që kishte ndodhur. Më telefonuan edhe mua në Selitë. Ai që fliste kërkoi të gjendesha shpejt në Klos. Ishte rrezik që kooperativistët t'i zinin me gurë fajtorët. Qe ngri-

tur në këmbë kooperativa. Kur erdha në Klos, njerëzit nuk zinin vend. Prindërit e Vules dhe «krushqit» qëndronin në një anë të mërzitur; si duket pesha e përbuzjes kolektive e kishte rënduar mjaft. Asnjëri nuk çonte krye, pinin cigare njëra mbas tjetrës. Disa nga të moshuarit më dolën përpara:

— Këta nuk po marrin vesh se ç'po ndodh te ne. Na turpëruan! I vunë njollë kooperativës. S'ja dinë kimetin vajzës që kanë.

Ndërsa nga mbledhja thërrisnin me zë të lartë:


— T'i përzëmë nga fshati!

Të them të drejtën, më vinte mirë kur i shihja të gjithë fshatarët të revoltuar. Masa është gjithnjë kundër fanatikëve dhe mendjeve të mykura. Shoku Enver na ka dhënë një armë të fuqishme për të zhdukur plagët e botës së vjetër me fjalët e tij të 6 shkurtit.

Për t'i folur asaj mase njerëzish që shfrynte kundër prapanikëve, më dhanë dorë letra e çikave nga Lekbibaj dhe përgjegjja që u dërgonte shoku Enver atyre; po kooperativistët qenë mjaft të revoltuar dhe nuk përmbaheshin. Atëhere punët i vuri në rrugë Vule Qosja. Në mes të mbledhjes ajo ju drejtua të jatit me këto fjalë:

— Çfarë isha unë, o baba?! Lopë isha unë? Qen isha? Pse doje të më ndiqje me turp nga shtëpia? Ç'të bëra? Ç'faj të pata? Mos të frynë në vesh fanatikët? Mos vallë të trëmbi hekurudha? Kot të zuri frika! Në hekurudhë ne do të shkojmë për të punuar e për t'u edukuar.

Kështu foli Vule Qosja atë ditë në mes të mbledhjes, zjarr e shpuzë. Na mallëngjeu shejtanka!



Babai i Vules u ngrit aty në shesh të fshatit, midis gjithë popullit, dhe e përqafoi të bijën.

— Kapedanja e babait! Vullnetarja e babait! — këto foli e mjekra i dridhej. Pastaj nuk hapi më gojë, qe mjaft i tronditur. U ul pranë së bijës e nuk ju nda. Duart ja pat marrë midis duarve të veta e veç ja ledhatonte.

Pas këtij pajtimi, mbledhja vendosi që në fshatrat e krahinës sonë të mos ndodhnin më kësi ngjarjesh të shëmtuara. Të gjithë aprovuan vendimin: të rinj e pleq, edhe prindërit e Vules e ngritën dorën me gjithë zemër.

50972

LIBRARI E SHTETIT

SHKURTORJA

PËRMBAJTJA E LËNDËS

	Faqe
I	
Horizonte të elektrifikuara	3
Për një ballë fishekë	13
Mbas demonstratës	25
Tik Fishnjari	39
Merkur Panxhi	47
II	
Lekua i Telo Rrapit	59
Një ngjarje në Lugaxhi	79
Ëndërra	93
Vajza nga Klosi i Sulovës	105